



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional: “Studime të Sigurisë”, me profile: 1. Çështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitikë; 4. Siguria e Sistemeve të Informacionit; 5. Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh.”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**“Universiteti Europian i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Islam Jusufi

2. Dr. Elda Zotaj

Shkurt/2020

# PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

## Përshkrim përmbledhës

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional ‘Studime të Sigurisë’ me pesë profile është program studimi i riorganizuar në vitin 2018 me urdher MASR nr. 663 dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare të Universitetit Europian i Tiranës.

Programi i studimit realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Studime të Sigurisë”, me profile: 1.Çështje të Sigurisë; 2.Studime Rajonale; 3.Gjeopolitikë; 4.Siguria e Sistemeve të Informacionit; dhe 5.Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh.

Ky program studimi synon të përçojë tek studentët njohuri teorike dhe praktike për të zhvilluar mendimin kritik të studentëve. Ky program synon ta pajisë studentin me aftësi të ndryshme, të tilla si: thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve; aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor; përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit; dhe praktika në institucione të fushave përkatëse.

Ky program studimi ofron mundësi studentëve që të fitojnë njohuritë e duhura teorike dhe aftësimin e tyre në fushën e studimeve të sigurisë. Programi ka një përputhje me objektivat e UET si dhe me interesat kombëtare në formimin e kapaciteteve humane që kanë aftësi për bërjen dhe implementimin e politikave të sigurisë.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Raporti është përgatitur nga një Grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me urdhër nr.83, datë 16.10.2019, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Një nga vlerësuesit veproi si kryetar grupi i cili kishte si detyrë që të uniformizojë të gjithë raportin.

Grupi, në vlerësimin e tij është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga UET, dokumentacioni shoqërues i raportit dhe mbi vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 12-13 Dhjetor 2019. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në UET, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e UET të përfshirë në këtë proces, nga departmenti deri tek zyrat menaxheriale dhe horizontale siç janë burimet njerëzore, financa, sekretaria e mësimit, si dhe takime me studentët e programit.

Ecuria e procesit është kordinuar nga Specialisti i ASCAL-it i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

Më datë 31.01.2020 dërgohet në institucion me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.9/16 Prot. Dt.31.01.2020, draft raporti i vlerësimit të jashtëm. Institucioni ka sjellë me anë të sistemit AMS datë 07.02.2020 dhe shkresës nr.9/17 prot Ascal, datë 10.02.2020, komentet mbi draft raportin. GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

Për komentin: Në lidhje me standardin I.3 grupi i vlerësimit shprehet: "*Vërehet mungesa e studimeve periodike të tregut të punës, (Ref. RVB fq. 6-8; Studimi i Tregut të Punës), Përmbajtja e programit të studimit përfshin lëndë të ndryshme që janë në frymë të studimeve të sigurisë, por nuk janë të mjaftueshëm që të garantojnë përfundimin e dijeve dhe kompetencave të duhura që lehtësojnë punësimin e studentëve në nivel të MP. Të diplomuarit e këtij Masteri Profesional janë punësuar në fusha të ndryshme, por shumë pak në institucione të sigurise, politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. (Ref. RVB fq. 6-8; Kurrikula e programit). Ofrimi i programit me pesë profile, i jep mundësi studentëve të përzgjedhin në bazë të interesave të tyre profesionale, por vërehet mungesa e lëndëve me zgjedhje. (Ref. RVB fq. 6-8; Rregullore e programit të studimit; Kurrikula e programit)". (faqe 5 draft raport).*

Në lidhje me konstatimin "*mungesa e studimeve priodike të tregut të punës*", mund të thuhet qe kjo është pikërisht ajo që bëhet në UET, në nivel institucioni dhe atë departamental. Së pari, takimet dy herë në vit me Anëtarë të Bordit të Tregut të punës, ku pjesa dërrmuese e tyre janë ish studentë të UET, por që kanë zënë pozicione të rëndësishme në institucionet apo kompanite e ndryshme është një burim informacioni mbi raportet e kërkesave të tregut dhe ofertës akademike. Së dyti, panairi i tregut të punës që zhvillohet në fillim të Majit dhe ku marrin pjesë mbi 50 institucione publike dhe private, të cilat operojnë në fushën e Shkencave Sociale dhe takimet me ta gjatë këtij aktiviteti ndër të tjera janë dhe marrje informacioni mbi kërkesat e tregut. Së treti, Programi 500+ ku studentëve iu ofrohet rëndësia

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

të ndjekin praktikat profesionale janë një tjetër indikator për të kuptuar konjunkturën e tregut. Së katërti forumet e ditës së Martë, ku brenda një viti janë të ftuar mbi 15 aktorë të rëndësishëm të fushës së Shkencave Sociale, të cilët japin eksperiencat e tyre. Së fundi, "Cmimi Alumni" një aktivitet ku ndër të tjera 10 ish studentët më të mirë të departamentit japin mesazhet e tyre mbi prespektivat e tregut të punës. Pika "Përmbajtja e programit të studimit pëfshin lëndë të ndryshme që janë në frymë të studimeve të sigurisë por nuk janë të mjaftueshme që të garantojnë përfundimin e dijeve dhe kompetencave të duhura që lehtësojnë punësimin e studentëve në nivel MP", ky është një konkluzion që duhet marrë me rezerva, pasi për të ideuar lëndët bazë dhe lëndët e profilit janë marrë si referenca praktikat më të mira të Universiteteve anglosaksone, studimi i detajuar dy- vjecar i tregut. Gjithashtu në të gjitha fokus grupet dhe anketimet semestrale, të cilat i zhvillojmë me studentët e Masterit Profesional nuk është ngritur si shqetësim, po ashtu, në takimet me studentët Alumni dhe Anetarët e Bordit të Tregut të punës nuk konstatohet ky problem. Nëse do të konstatohej sigurisht do ta reflektonim në riorganizimin e lëndëve dhe profileve.

Ju shpreheni "Ofrimi i programit me pesë profile, i jep mundësi studentëve të përzgjedhin në bazë të interesave të tyre profesionale, por vërehet mungesa e lëndëve me zgjedhje" Pra studentët kanë mundësi zgjedhjeje jo në nivel lëndësh të vecanta, por në nivel profilesh. Studentët kanë mundësi që të zgjedhin ndër pesë profilet dhe brenda tyre janë dhe lëndët që lidhet me profilet në fjalë.

Nisur nga çfarë komentuar më lartë, i sugjeroj ekspertëve të rishikojnë mundësinë për të rivlerësuar edhe njëherë këtë pikë.

#### **GVJ: Raporti në këtë pikë ndryshon (fq. 11-12).**

Për komentin: Në lidhje me standardin I.4 grupi i vlerësimit shprehet: "Organizimi i institucionit, i cili ka në përbërje 5 fakultete (dhe departamentet përkatëse) krijon mundësinë për zhvillimin e një masteri profesional me lëndë ndër-disiplinore, i cili mbështetet nga kontributi jo vetëm i departamentit përkatës por edhe nga fakultetet e tjera. Dy prej profileve të programit të studimit (Siguria e Sistemeve të Informacionit dhe Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh) ofrohen në bashkëpunim me Departamentin e Informatikës dhe departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut. Sidoqoftë MP Studime të Sigurisë është një program në vete dhe dublikimet me programe të tjera janë të vogla, qoftë në target grup si dhe në stafin mësimdhënës. Për arsye të ekzistencës së lëndëve ndërdisiplinore, një pjesë e lëndëve zhvillojnë leksione të përbashkëta me programe të tjera. Në këto situata, duhet të ketë përshtatje të mësimëve me nevojat e studentëve të MP Studime të Sigurisë. GVJ, bazuar në RVB si dhe bazuar në vizitën në institucion vërejtje që njësia bazë ishte në korrent të përgjegjësive në lidhje me programin e studimit dhe ishte e angazhuar seriozisht për vënien e tij në jetë". (faqe 7 draft raport).

Programi "Studime të Sigurisë" ka përveç lëndës "Metoda Kerkimi të Avancuara" tre lëndë karakterizuese të programit, të cilat lidhen vetëm me fushën e sigurisë, plus 3 lëndë të lidhura ngushtësisht me profilet: "Çështje të Sigurisë", "Gjeopolitika" dhe "Studimet Rajonale" dy profilet e tjera "Siguria e Sistemeve të Informacionit" dhe "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" kanë lëndë, të cilat burojnë nga departamentet e tjera dhe është normale që të zhvillohen me studentët e departamenteve të tjera. Pra është konceptuar që studentët të profilizohen brenda tre profileve bazë të programit të Sigurisë, por të mos

përrjashtohet mundësia e përzgjedhjes së një profili që buron nga departamentet e tjera, me qëllim lidhjen e programit me ekspertizën që i kërkohet në vendin e punës ose synon të aplikojë. Sic e keni evidentuar edhe ju në raport, një pjesë e studentëve janë të punësuar në kompani apo institucione që nuk lidhet me degën që kanë përfunduar, kështu që ata kanë interes që të nderthurin formimin bazë në Marrëdhënie Ndërkombëtare me njohuritë e profilizuara në një program tjetër, por që lidhet me vendin e punës.

Nisur nga cfarë komentuam më lartë, i sugjeroj ekspertëve të rishikojnë mundësinë për të rivlerësuar edhe njëherë këtë pikë.

#### **GVI: Raporti në këtë pikë ndryshon (fq. 13).**

Për komentin: Në lidhje me standardin I.5 grupi i vlerësimit shprehet: *“Nuk ka marrëveshje të mjaftueshme bashkëpunimi me institucionet specifike në fushën e sigurisë. Institucioni mund dhe duhet të bëjë një punë më të mirë, nëpërmjet zyrës së marrëdhënies me publikun, për afirmimin e programit MP Studime të Sigurisë, duke marrë parasysh numrin e ulët të regjistrimeve të studentëve të programit. Vërehet prania e stafit akademik me përvojë specifike në fushën e studimeve ushtarake. (Ref. RVB, fq. 10-11; Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit; Takim me GVB)”. (faqe 9 draft raport).*

Në nivel departamenti ne kemi tre marrëveshje të zyrtarizuara, por sic e thoni dhe ju më poshtë *“Institucioni bashkëpunon me aktorë të ndryshëm, akademik dhe jo-akademik, me qëllim ngritjen e urave të bashkëpunimit me tregun e punës dhe mundësinë e praktikave të vlefshme profesionale për studentët e programit. Institucioni po ashtu bashkëpunon dhe me aktorët e institucione të tjera, me të cilat pavarësisht se nuk ka marrëveshje të shkruara, kanë rënë dakord për të pranuar studentë për zhvillimin e praktikës profesionale”*. Pra, institucioni ka marrëveshje dhe bashkëpunime në kuadrin e projektit 500+ por jo të zyrtarizuar. Në këtë frymë dhe departamenti ka bashkëpunime me 50-të aktorë të rëndësishëm, në fushën e Marrëdhënies Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike. Në lidhje me fushën e Sigurisë një numër studentësh prej vitesh zhvillojnë praktikën në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Jashtë dhe Ministrinë e Rendit, por për vetë specifikat, që kanë këto institucione nuk lëshojnë dokument zyrtar bashkëpunimi.

Nisur nga cfarë komentuam më lartë, i sugjeroj ekspertëve të rishikojnë mundësinë për të rivlerësuar edhe njëherë këtë pikë.

#### **GVI: Raporti në këtë pikë ndryshon (fq. 14-15).**

Për komentin: Në lidhje me standardin II.1 grupi i vlerësimit shprehet: *“Kurrikula e paraqitur, trajtimi i tematikave në syllabuset dhe metodologjia ndërdisiplinore, dëshmojnë synimet e programit për të zgjeruar më tej njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve. Brenda programit të studimit mund të ishte bërë, vecanërisht tek tre profilet e para (1. Cështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitike), një zgjedhje më e madhe e lëndëve me fokus profesional sikundër janë tek të dy profilet e fundit (4. Siguria e Sistemeve të Informacionit; 5. Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh). Kjo gjë është e rëndësishme duke marrë parasysh se tregu i punës është i tejmbushur dhe se programi duhet të ketë specifika të qarta për ta dalluar atë nga programet egzistuese analoge. (Ref. Kurrikula e programit)”. (faqe 10 draft raport).*

Diferenca që bëni ju mes dy profileve që i përkasin dy departamenteve të tjera si 'Siguria e Sistemeve të Informacionit' dhe "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh" ka një logjike. Dy profilet e para burojnë nga dy departamente të ndryshëm, ndërsa tre profilet: "1. Cështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitike, burojnë nga programi i Sigurisë. Gjithashtu, diferencën ndërmjet tre profileve e bëjnë dy lëndë që i japin kuptim profilizimit, ndërsa lënda e tretë është plotësuere tek të tre profilet.

Nisur nga çfarë komentuam më lartë, i sugjeroj ekspertëve të rishikojnë mundësinë për të rivlerësuar edhe njëherë këtë pikë.

**GVI: Raporti në këtë pikë ndryshon (fq. 15-17).**

Për komentin: Në lidhje me standardin II.2 grupi i vlerësimit shprehet: *“Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete administrative ndihmëse (sic është rasti i zyrave të burimeve njerëzore, sekretaria e mesimit, etj) mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave, por duke mbajtur parasysh që kjo të mos sjellë një mbi-ngarkesë, e cila mund të prekë cilësinë e punës, (Ref. RVB, fq. 13-14; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit). Fakulteti ka emëruar koordinators të programit të studimit. Por ekziston nevoja për harmonizimin e punës midis koordinators të programit të studimit dhe përgjegjës të grup-lëndëve, (Ref. RVB, fq. 13-14; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit). Sipas vendimit të Dekanit të Fakultetit për caktimin e Koordinators të programit të studimit, koordinators ndjek ecurinë e zhvillimit të programit, shqyrton cilësinë e syllabuseve, ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale, etj. Por, në praktikë, puna e koordinators ende nuk është parë dhe dokumentuar. (Ref. RVB, fq. 13-14; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit).”* (faqe 11- 12 draft raporti).

*“Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete administrative ndihmëse (sic është rasti i zyrave të burimeve njerëzore, sekretaria e mesimit, etj) mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave, por duke mbajtur parasysh që kjo të mos sjellë një mbi-ngarkesë, e cila mund të prekë cilësinë e punës”.* Ngarkesa është e përcaktuar sipas ligjit, praktikave të mira të Universiteteve dhe është e materializuar në kontratat individuale. Etiketingu i ngarkuar dhe opinioni i shprehur në frazën “mund të prekë cilësinë e punës”. Treguesit e cilësisë që të mbahen në parametrat e mirë përcaktuara janë të matura në UET, nëpërmjet procesit të Follow up-it një herë në vit, formulareve të deklarimit për punën shkencore, didaktike dhe administrative, si dhe në vlerësimin periodik të studentëve çdo fund simestri, nëpërmjet fokus grupeve dhe anketimeve. Nuk ka ndonjë të dhënë objektive deri tani, që të ketë ndonjë pedagog me më shumë ngarkesë sic e parashikon ligji, rregullorja e UT dhe praktikave të mira të Universiteteve në Perëndim. Megjithatë kjo mbetet çështje interpretimi.

Ju shprehni nevojën për harmonizimin e punës midis koordinators të programit të studimit dhe përgjegjës të grup-lëndëve. (Ref. RVB, fq. 13-14; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit). Ne nuk kemi kordinators programi, por përgjegjës për grup lëndët. Pedagogu që ka titullin Profesor dhe është më afër ekspertizës së Marrëdhënies Ndërkombëtare është përgjegjës për grup lëndët, që i takojnë kësaj fushe dhe kolegu tjetër është përgjegjës për grup lëndët, që i përkasin fushës së Shkencave

Politike, Sociologji dhe Antropologji. Numri shumë i vogël i studentëve në Sociologji dhe Antropologji në nivel bachelor ka bërë të mundur që të jetë i njëjti person për të dy programet.

Ju shpreheni "*Sipas vendimit të Dekanit të Fakultetit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit, koordinatori ndjek ecurinë e zhvillimit të programit, shqyrton cilësinë e syllabuseve, ndjek ecurinë e praktikave profesionale etj. Por në praktikë puna e koordinatorit ende nuk është parë e dokumentuar*". Në departament është përgjegjësi i grup lëndëve sic e shpjegova më lart i cili ndjek procesin akademik. Cdo silabus, tezë provimi, tema esesh, kalojnë në filtrin e përgjegjësit të grup lëndëve. I gjithë ky proces lë gjurmë në indikatorët e vlerësimit që bën ai për silabuset përkarah emrit të drejtuesit të departamentit në formularin e tezave dhe temave të eseve.

Nisur nga çfarë komentuam më lartë, i sugjeroj ekspertëve të rishikojnë mundësinë për të rivlerësuar edhe njëherë këtë pikë.

#### **GVJ: Raporti në këtë pikë ndryshon (fq. 17-18).**

Për komentin: Në lidhje me standardin II.3 grupi i vlerësimit shprehet: "*Vërehet akses i kufizuar i publikut më gjërë tek informacionet e institucionit dhe atyre të programit MP Studime të Sigurisë në faqen zyrtare të universitetit në internet. Akses i dokumentet e duhur është kufizuar vetëm për ata që kanë hyrje në sistemin LMS të universitetit. (Ref. RVB, fq. 15-16; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit)*". (faqe 12 draft raport).

Nisur nga kriteret që janë përcaktuar në formular në lidhje me këtë pikë, grupi i ekspertëve shpjegon që janë përmbushur të gjitha përveç vërejtjes "*Vërehet akses i kufizuar i publikut më gjërë tek informacionet e institucionit dhe atyre të programit MP Studime të Sigurisë në faqen zyrtare të universitetit në internet. Akses i dokumentet e duhur është kufizuar vetëm për ata që kanë hyrje në sistemin LMS të universitetit. (Ref. RVB, fq. 15-16; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit)*". Institucioni ka një faqe zyrtare online në gjuhët shqip dhe anglisht dhe janë të publikuara të gjitha informacionet bazë që ka interes publiku i gjërë. Ndërsa, akses i sistemin LMS është vetëm për studentët pasi informacioni është i adresuar vetëm për ta. Sic janë pikët e eseve, pikët e provimit të ndërmjetëm, sillabuset dhe literatura përkatëse. Kjo është një praktikë që ndiqet nga një pjesë e mirë e universiteteve.

Nisur nga çfarë komentuam më lartë, i sugjeroj ekspertëve të rishikojnë mundësinë për të rivlerësuar edhe njëherë këtë pikë.

**GVJ: Akses i publikut më gjerë mungon në faqen zyrtare të universitetit në internet tek informacionet siç janë rregullorja e programit të studimit; syllabuset e programit të studimit, etj. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Për komentin: Në lidhje me standardin II.6 grupi i vlerësimit shprehet: "*Studentët në përgjithësi janë përfshirë te Bordi i Tregut të Punes dhe te fokus grupet e Departamentit. Por vërehet aktivizimi i kufizuar i studentëve në aktivitetet kerkimore, administrative, dhe mësimore. Përfshirja a studentëve të MP si ndihmës/asistent për të ndihmuar pedagogët në procesin mbështetës mësimor mund të jetë një mjet i përfshirjes së studentëve*". (faqe 16 draft raport).

Përsa i përket përfshirjes së studentëve në aktivitete administrative, mësimore dhe kërkimore mund të thuhet që në departament zhvillohen aktivitete të përjavshme nëpërmjet klubit studentor "Karl Marks". Në kuader të aktiviteteve ekstrakurikulare në forumet UET janë të ftuar personalitete edhe nga fusha e Marrëdhënieve Ndërkombetare. Lektorë të ftuar që kanë zhvilluar leksion të hapur me studentët e Marrëdhënieve Ndërkombetare. Këtu vlen të përmendim edhe ndryshimet e legjislacionit që trajton praktikën profesionale, i cili ngarkon me kosto financiare institucionet/kompanitë që pranojnë studentë për të kryer praktikën, pasi ata janë të detyruar të paguajnë dhe të sigurojnë studentët për periudhën e kryerjes së praktikës. Kjo e vështirëson lidhjen e marrëveshjeve me institucionet/kompanitë, pasi ato hezitojnë të marrin përsipër kosto financiare fikse, ndaj edhe nuk ka qënë e mundur që bashkëpunimet të formalizohen me marrëveshje mes palëve, por bashkëpunimi është i vazhdueshëm dhe studentët janë akomoduar rast pas rasti. I rëndësishëm është fakti që, megjithë vështirësitë që shoqërojnë këtë proces, deri më sot, UET ka garantuar që të gjithë studentët e programeve Master të arrijnë të kryejnë praktikën profesionale brenda afatit të përcaktuar në planin mësimor të programit.

Mendojmë që grupi i vlerësimit nisur nga pengesa e natyrës ligjore më sipër, ta rishohë vlerësimin e dhënë për këtë pikë - standardet janë plotësuar kryesisht.

GVJ: Aktivizimi i kufizuar i studentëve në aktivitetet kërkimore, administrative, dhe mësimore mbetet si realitet. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Shpresojmë se shpjegimet e mësipërme do të merren në konsideratë nga GVJ, për t'u reflektuar në vlerësimin përfundimtar të tyre. Sidoqoftë, falenderojmë edhe njëherë grupin e vlerësimit për punën shumë profesionale dhe me objektivitet në tërësi si dhe një pjesë e rekomandimeve do të shërbejnë si plan pune për të bërë përmirësimet përkatëse.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Studime të Sigurisë, me profile: 1. Çështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitikë; 4. Siguria e Sistemeve të Informacionit; 5. Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	GVJ vlerëson se Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Studime të Sigurisë, me profile: 1. Çështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitikë; 4. Siguria e Sistemeve të Informacionit; 5. Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është në harmoni me interesat kombëtare pasi një programi i tillë ka një rol të rëndësishëm në arritjet e interesave kombëtare siç janë përgatitja e vendit për integrim në BE, në kontributin e saj në NATO, dhe për pajisjen e vendit me njerëz të përgatitur në fushën e sigurisë. (Ref. RVB, fq. 4).			
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Informacioni i paraqitur nga institucioni shpjegon se si vlerat akademike dhe kulturore të vendit si një shtet demokratik dhe European promovohen dhe ruhen nëpërmjet edukimit të studentëve dhe partneriteteve me institucione të rëndësishme të vendit. (Ref. RVB fq. 4, Plani Strategjik, Statuti).			
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ka një përputhje të kënaqshme të programit të studimit me misionin dhe qëllimin e institucionit duke marrë parasysh karakteristikat e programit. Institucioni ofron programe studimi të afërta me këtë program studimi. UET tregon vullnet institucional për arritjet e programit. (Ref. RVB , fq. 4, Statuti, Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe me Përgjegjësin e Departamentit).			
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Zhvillimi ekonomik i vendit do të mundësojë rritjen e numrit të studentëve, në mënyrë që institucioni të justifikojë programin. Sfidë është tregu tejet i mbushur i punës dhe prania e programeve paralele në treg. Specifikisht, programi i studimit fokusohet me çështje specifike dhe bashkëkohore në fushën e studimeve të sigurisë. Suksesi i programit do të nxitë zhvillimin ekonomik kombëtar pasi programi kontribon në afrimin e vendit me politikat e BE-së dhe NATO-s në fushën e sigurisë. (Ref. RVB, , fq. 4).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë	Bazuar në DVV dhe në vitizitën në institucion, në UET u vërejt

se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	prania e Plani Strategjik 2015-2020 të vetë institucionit, i cili synon rritjen e cilësisë së programeve. Në planin strategjik, UET paraqet planet për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Specifikisht, siç përcaktohet në Planin Strategjik 2015 – 2020, programi i studimit kërkon të rrisë numrin e individëve të kualifikuar, duke ofruar inovacionin në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor. Por, vërehet mungesa e një plani strategjik specifik të Departamentit përkatës ose të programit të studimit. Ky dokument do të mundësonte harmonizimin e planit strategjik të programit ose të Departamentit me strategjinë e universitetit që të trajtohen në nivel departamental dhe institucional sfidat që kanë të bëjnë me përmirësimin e suksesit të programit të studimit. (Ref. RVB , fq. 5; Plani Strategjik 2015-2020; Takim me Dekanin e Fakultetit dhe përgjegjës in e departamentit).			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Drejtimit prioritar akademike janë të përcaktuara në Statuti UET, Rregullore UET, Plani Strategjik 2015 – 2020, dhe tek Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017 – 2020. Por, mungojnë referime për programin e studimit MP Studime të Sigurisë, tek statuti, rregullorja dhe planet strategjike të UET. (Ref. RVB fq. 5, Statuti, Rregullore, Plani Strategjik; Strategjia e Kërkimit Shkencor).			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi Master Profesional në Studime të Sigurisë organizohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet e sigurisë janë pjesë e koncentrimin të universitetit. Por, vërehet mungesa e një qëndre hulumtuese me përqendrim në studimet e sigurisë që mund të bashkëveprojë me departamentin që organizon programin e studimit. (Ref. RVB, fq. 5).			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Programi është ndërtuar në përputhje me prioritetet e UET dhe është në dakortësi me trendet Europiane të arsimit të lartë siç është “Karta e Bolonjës”, por vërehet mungesa e referimit tek dokumentet e institucionit me strategjitë kombëtare të zhvillimit. (Ref. RVB, fq. 5, Strategjitë e institucionit).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	GVJ konstaton se programi i studimit ka objektiva të përcaktuara për formimin e studentëve të cilët pasqyrohen tek Rregullore e programit të studimit MP Studime të Sigurisë. Vërehet mungesa e objektivave që kanë të bëjnë direkt me dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. Në realizimin e këtij kriteri, problematik mbetet tregu i tejmbushur i punës. Sfidat ekonomike të vendit nuk e mundësojnë rritjen e numrit të studentëve. Evidentohet një rrënie në numrin e regjistrimit të studenteve në këtë

	program nga viti 2018 në vitin 2019. (Ref. RVB, fq. 6-8; Rregullore e programit të studimit; Takimet me GVB dhe stafin akademik).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Përpara hapjes së programit MP Studime të Sigurisë është realizuar studimi i tregut të punës. Tregu i punës ka shërbyer si bazë për të përcaktuar përmbajtjen e kurrikulës dhe profilizimet e programit. UET zhvillon edhe veprimtari të tjera të rregullta për të matur nevojat e tregut të punës. Takimet dy herë në vit me Anëtarë të Bordit të Tregut të punës, ku pjesa dërrmuese e tyre janë ish studentë të UET, por që kanë zënë pozicione të rëndësishme në institucionet apo kompanite e ndryshme është një burim informacioni mbi raportet e kërkesave të tregut dhe ofertës akademike. Gjithashtu, panairi i tregut të punës që zhvillohet në fillim të Majit dhe ku marrin pjesë institucione publike dhe private, të cilat operojnë në fushën e Shkencave Sociale dhe takimet me ta gjatë këtij aktiviteti ndër të tjera janë dhe marrje informacioni mbi kërkesat e tregut. Përveç kësaj, Programi 500+ ku studentëve iu ofrohet mundësia të ndjekin praktikat profesionale janë një tjetër indikator për të kuptuar konjunkturën e tregut. Gjithashtu, forumet e ditës së Martë, ku brenda një viti janë të ftuar aktorë të rëndësishëm të fushës së Shkencave Sociale, të cilët japin eksperiencat e tyre. Përveç kësaj, “Çmimi Alumni” një aktivitet ku ndër të tjera ish studentët më të mirë të departamentit japin mesazhet e tyre mbi prespektivat e tregut të punës. (Ref. RVB fq. 6-8; Studimi i Tregut të Punës).
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Përmbajtja e programit të studimit përfshin lëndë të ndryshme që janë në frymë të studimeve të sigurisë. Për të ideuar lëndët bazë dhe lëndët e profilit janë marrë si referenca praktikat më të mira të Universiteteve anglosaksone. Të diplomuarit e këtij Masteri Profesional janë punësuar në fusha të ndryshme, por shumë pak në institucione të sigurisë, politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. (Ref. RVB fq. 6-8; Kurrikula e programit).
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	UET është shumë i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit. Programi i studimit është organizuar sipas standardave të Bolonjës që lehtësojnë transferimin e studimeve me ECTS. Hapja e studimeve të sigurisë është një trend global në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. (Ref. RVB fq. 6-8; Marrëveshjet e bashkëpunimit).
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	Ky MP është i organizuar në përputhje me prioritetet e RSh-së për të arritur sisteme të arsimit të lartë të krahasueshëm dhe të pajtueshëm me vendet e tjera të Evropës. Programi i studimit MP në Studimet e Sigurisë përkon me nivelin 7 të Kornizës Europiane dhe Shqiptare të Kualifikimit. (Ref. RVB fq. 6-8).
<b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet	Praktika profesionale është një nga detyrimet akademike të programit. Rregullorja e programit të studimit thekson si një ndër objektivat kryesore të programit aftësimin profesional të studentit. Rregullorja nuk e përcakton në mënyrë të detajuar aftësitë profesionale. Ofrimi i programit me pesë profile, i jep mundësi

e rregulluara.	studentëve të përzgjedhin në bazë të interesave të tyre profesionale. Studentët kanë mundësi zgjedhjeje jo në nivel lëndësh të veçanta, por në nivel profilesh. Studentët kanë mundësi që të zgjedhin ndër pesë profilet dhe brenda tyre janë dhe lëndët që lidhet me profilet në fjalë. (Ref. RVB fq. 6-8; Rregullore e programit të studimit; Kurrikula e programit).			
<b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, programi i studimit ofron mundësitë që studentët të angazhohen edhe në gjuhë të huaj përmes aktiviteteve të ndryshme që organizohen në universitet gjatë vitit akademik. (Ref. RVB fq. 6-8; takimet me GVB, stafi akademik dhe studentët).			
<b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Programi ofrohet në mënyrë të përhershme.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Struktura institucionale e UET-së është në funksion të misionit dhe e organizuar në përputhje me fushën akademike specifike për ofrimin e programit MP Studime të Sigurisë. Sasia, kualifikimi dhe cilësia e stafit akademik të brendshëm kryesisht dhe stafit të jashtëm, janë tregues të përvojës dhe kapaciteteve të duhura në ofrimin e programit në fushën e studimeve të sigurisë. Në organizimin, mbushjen e misionit dhe objektivave rekomandojmë që stafi i brendshëm akademik të zgjerohet edhe me lektorë të ftuar. (Ref. RVB, fq. 8-9).
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Universiteti European i Tiranës është i organizuar në pesë Fakultete duke përmbushur kështu detyrimet ligjore. Struktura organizative e universitetit është në përmbushje të kriterëve ligjore. Misioni i tyre është arritja e objektivave lidhur me përsosjen e proceseve mësimore dhe kërkimore. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare ku përfshihet edhe programi i studimit ka një eksperiencë mbi 10 vite. (Ref. RVB, fq. 8-9).
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese	Programi ofrohet nga njësi bazë që është Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, i cili miraton programet mësimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme pranë organeve drejtuese të Universitetit. Organizimi i institucionit, i cili ka në përbërje 5 fakultete (dhe departamentet përkatëse) krijon mundësinë për zhvillimin e një masteri profesional me lëndë ndër-disiplinore, i cili mbështetet nga kontributi jo vetëm i departamentit përkatës por edhe nga fakultetet e tjera. Dy prej profileve të programit të

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

duhet ta sigurojë këtë përputhje.	studimit (Siguria e Sistemeve të Informacionit dhe Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh) ofrohen në bashkëpunimin me Departamentin e Informatikës dhe Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut. Sidoqoftë, MP Studime të Sigurisë është një program në vetë dhe dublikimet me programe të tjera janë të vogla, qoftë në target grup, si dhe në stafin mësimdhënës. Për arsye të ekzistencës së lëndëve ndërdisiplinore, një pjesë e lëndëve zhvillojnë leksione të përbashkëta me programe të tjera. Dy profilet "Siguria e Sistemeve të Informacionit" dhe "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh" kanë lëndë të cilat burojnë nga departamentet e tjera dhe lëndët zhvillohen me studentët e departamenteve të tjera. GVJ, bazuar në RVB si dhe bazuar në vizitën në institucion vërejtë që njësia bazë ishte në korrent të përgjegjësive në lidhje me programin e studimit dhe ishte e angazhuar seriozisht për vënien e tij në jetë. Në tërësi, departamenti dhe anëtarët e tij, përgjegjësi i departamentit dhe disa prej lektorëve dëshmuar vetëdije dhe përgjegjësi në realizimin e programit të studimit. (Ref. RVB , fq. 8-9; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe përgjegjësi i Departamentit).			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	MP Studime të Sigurisë është brenda profilit të UET-it dhe cilësia e tij garantohej nga kapacitetet dhe burimet institucionale. (Ref. RVB, fq. 8-9).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Organizimi i institucionit harmonizon strukturat akademike me ato vendim-marrëse dhe administrative. Strukturat akademike janë të ndërlidhura dhe propozojnë pranë strukturave menaxheriale ndryshimet e nevojshme. Gjithashtu, detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloret e institucionit. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive menaxheriale dhe horizontale të institucionit, por pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. (Ref. RVB, fq. 10-11; Statuti; Takimet me GVB, stafi akademik, Dekanin e Fakultetit dhe përgjegjësi i Departamentit).
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Institucioni është i fokusuar dhe i hapur ndaj bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe ka zyra të dedikuara dhe efektive për këtë bashkëpunim si në fushën e mobilitetit ashtu edhe në menaxhimin e projekteve të financuara prej fondeve Europiane dhe ndërkombëtare. Njëkohësisht, Institucioni ka arritur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm. Institucioni gjithashtu ka marrëveshje me institucione ndërkombëtare akademike me qëllim

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<p>lëvizshmërinë e studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ. Institucioni dhe Departamenti kanë marrëveshje dhe bashkëpunime në kuadrin e projektit 500+ me aktorë të rëndësishëm. Ekzistojnë tre marrëveshje bashkëpunimi me institucionet specifike në fushën e sigurisë. Një numër studentësh kanë kryer praktikën në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Jashtme dhe Ministrinë e Rendit. Institucioni mund dhe duhet të bëjë një punë më të mirë, nëpërmjet zyrës së marrëdhënies me publikun, për afirmimin e programit MP Studime të Sigurisë, duke marrë parasysh numrin e ulët të regjistrimeve të studentëve të programit. Vërehet prania e stafit akademik me përvojë specifike në fushën e studimeve ushtarake. (Ref. RVB , fq. 10-11; Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit; Takim me GVB).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Institucioni bashkëpunon me aktorë të ndryshëm, akademik dhe jo-akademik, me qëllim ngritjen e urave të bashkëpunimit me tregun e punës dhe mundësimin e praktikave të vlefshme profesionale për studentët e programit. Institucioni po ashtu bashkëpunon dhe me aktorët e institucioneve të tjera, me të cilat pavarësisht se nuk ka marrëveshje të shkruara, kanë rënë dakord për të pranuar student për zhvillimin e praktikës profesionale. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, veçanërisht me institucionet e sigurisë, do të mundësojnë studentëve ura bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm qoftë nga sfera publike dhe ajo private për t'i rritur mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit. Këto bashkëpunime, së bashku me “Panairin e Punës” që organizohet një herë në vit i ofrojnë mundësi të bollshme studentëve për të identifikuar praktika me dobi për degën e tyre dhe me potencial për punësim më afatgjatë në të ardhmen. (Ref. RVB , fq. 10-11; Takime me GVB).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje me institucione publike dhe jopublike që ndihmojnë studentët për kryerjen e praktikës profesionale. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme për zbatimin e praktikave profesionale. Nëpërmjet praktikave profesionale, siç u dëshmuar në takimin e GVJ me studentët, ata mësojnë një sërë aftësish teknike dhe profesionale që i japin atyre një mundësi më shumë për të qenë të suksesshëm në karrierë. (Ref. RVB , fq. 10-11; Takimet me GVB dhe studentët).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nuk ka informacion se institucioni ofron trajnime shtesë profesionale për studentët. (Ref. RVB, fq. 10-11; Takim me GVB).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara si njësi bazë ka hartuar një raport në të cilin analizohet arritjet e programit (Ref. Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP Studime të Sigurisë, 2019).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi MP Studime të Sigurisë është organizuar në dy semestra, ku një pjesë e semestrit të dytë është projektuar për zhvillimin e praktikës profesionale dhe hartimin e tezës përfundimtare. Bazuar në të dhënat e paraqitura dhe informacionin e prezantuar rreth programeve mësimore, programi i studimit është organizuar në lëndë dhe të vlerësuara në kredite në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi MP Studime të Sigurisë ka 60 kredite në total dhe zgjat një vit akademik. Lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 6 kredite (ECTS) po ashtu dhe praktika/internship, ndërsa punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm i formimit janë të vlerësuara me 12 kredite, duke bërë që në total ky master të ketë 60 ECTS. Një student për të mbyllur programin realizon 9 lëndë gjithsej. (Ref. RVB, fq. 11-13; Kurrikula e programit).
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Kurrikula e paraqitur, trajtimi i tematikave në syllabuset dhe metodologjia ndërdisiplinore, dëshmojnë synimet e programit për të zgjeruar më tej njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve. Tek tre profilet e para (1. Çështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitikë), diferencën ndërmjet tre profileve e bëjnë dy lëndë që i japin kuptim profilizimit, ndërsa lënda e tretë është plotësuese tek të tre profilet. Një zgjedhje më e madhe e lëndëve me fokus profesional ekziston tek të dy profilet e fundit (4. Siguria e Sistemeve të Informacionit; 5. Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh). (Ref. Kurrikula e programit).
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi MP Studime të Sigurisë ofrohet me pesë profile, të cilat diferencohen me tri lëndë, e për rrjedhojë u jep mundësi studentëve të orientohen në profilin që ata zgjedhin. Programi është organizuar që të pajisë studentin me konceptet dhe teoritë të fushës. (Ref. RVB , fq. 11-13; Kurrikula e programit; Takim me stafin akademik).
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi synon të formojë specialistë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike dhe profesionale në fushën e sigurisë. Theksi i programit, veçanarisht tek disa profile është më shumë në drejtimin akademik se sa profesional. (Ref. RVB , fq. 11-13; Takimet me GVB, stafi akademik dhe studentët).
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të	Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	për arsimin e lartë Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore të MASR. Egziston përputhshmëri e programit të studimit me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe atyre strategjike kombëtare. Bazuar në raportimin e RVB-së dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit është në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në RSh-së. (Ref. RVB, fq. 11-13; Takim me GVB).			
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Kurrikulumi i programit është organizuar sipas kategorive (A-E), edhe atë në lëndë bazë (A), karakterizuese (B), ndërdisiplinore/integruese (C), lëndë plotësuese (D) dhe detyrime përmbyllëse (E), siç është caktuar tek aktet nënligjore (VKM 41, 2018). Përqindjet janë në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Studenti merr 10% lëndë në Kategorinë A, 30% tek B, 30% tek C, 10% në kategorinë D, dhe 20% si detyrim përmbyllës (E), i cili është provim përfundimtar, ose punim diplome. Marrja parasysh e mesatarës së studentëve në hyrje në caktimin e llojit të detyrimit përmbyllës kufizon zgjedhjen e studentëve. Rekomendohet marrja parasysh e mesatarës në fund të semestrit të parë në përcaktimin e llojit të detyrimit përmbyllëse. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijes në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. (Ref. RVB, fq. 11-13; Kurrikula e programit; Takimet me GVB dhe stafi akademik).			
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Praktika profesionale ka 6 kredite, fakt që e bënë atë në përputhje me aktet nënligjore të arsimit të lartë në RSh (VKM 41, 2018). (Ref. RVB, fq. 11-13; Kurrikula e programit).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Bazuar në raportimin e RVB-së dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se njësia kryesore (Fakulteti të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare) dhe njësia bazë (Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara) është në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në RSh për akreditimin. (Ref. RVB, fq. 13-14; Statuti; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës in e Departamentit).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara drejtohet nga përgjegjësi i departamentit dhe është organizuar me koordinator të

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	programit të studimit edhe sipas Gruplëndëve, drejtuar nga përgjegjësit e gruplëndëve. (Ref. RVB, fq. 13-14).			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara posedon numrin e kërkuar të stafit akademik dhe atë në përgjithësi nga personel akademik i brendshëm me kohë të plotë, në përputhje me detyrimet ligjore. Departamenti ka në përbërje të tij, 15 pjesëtarë efektive si personel akademik dhe prej tyre 11 rezultojnë me gradën shkencore 'Doktor'. Departamenti përmbush kriteret ligjore për numrin e pedagogëve cilësia e të cilëve (nga pikpamja e titujve dhe gradave) është më e lartë se sa kërkon ligji. (Ref. RVB, fq. 13-14).			
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Personeli akademik i Departamentit është krejtësisht i përfshirë në arritjen e objektivave të programit të studimit. Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete administrative ndihmëse (siç është rasti i zyrave të burimeve njerëzore, sekretaria e mësimi, etj) mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave. Ngarkesa është e përcaktuar sipas ligjit, praktikave të mira të Universiteteve dhe është e materializuar në kontratat individuale. (Ref. RVB, fq. 13-14; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit).			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Në informacionin e paraqitur në RVB lidhur me stafin ndihmës, akademik, dhe administrativ shpjegohet organizimi i këtyre strukturave. Institucioni angazhon personelin ndihmës për përgatitjen e didaktikës mësimore. Praktika profesionale në kuadër të programit të studimit zhvillohet jashtë institucionit dhe ajo mbikëqyret nga një pedagog i departamentit, si edhe nga personi përgjegjës në institucionin ku zhvillohet praktika. (Ref. RVB, fq. 13-14).			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Fakulteti ka emëruar përgjegjës për grup lëndët. Pedagogu që ka titullin Profesor dhe është më afër ekspertizës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare është përgjegjës për grup lëndët, që i takojnë kësaj fushe dhe kolegu tjetër është përgjegjës për grup lëndët, që i përkasin fushës së Shkencave Politike, Sociologji dhe Antropologji. (Ref. RVB, fq. 13-14; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit).			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesit i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Përgjegjësi i grup lëndëve ndjek procesin akademik, ndjek ecurinë e zhvillimit të programit, shqyrton cilësinë e syllabuseve, ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale, etj. (Ref. RVB, fq. 13-14; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit**

të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit disponon informacionin e duhur për organizimin e programit të studimit. Stafit dhe studentët kanë akses tek rregulloret dhe udhëzimet e institucionit dhe programit të studimit. Vërehet akses i kufizuar i publikut më gjerë tek informacionet e institucionit dhe atyre të programit MP Studime të Sigurisë (siç janë rregullorja e programit të studimit; syllabuset e programit të studimit, etj) në faqen zyrtare të universitetit në internet. Aksesit në dokumentet e duhur është kufizuar vetëm për ata që kanë hyrje në sistemin LMS të universitetit. (Ref. RVB, fq. 15-16; Takimet me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit).
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi MP Studime të Sigurisë organizohet në lëndë të përgjithëshme, karakterizuese, dhe ndër-disiplinore, praktikë profesionale dhe provim ose tezë mbyllëse. (Ref. RVB; Kurrikula e programit).
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi MP Studime të Sigurisë është organizuar me kohëzgjatje 1 vjeçare me 60 kredite (ECTS) të ndara në dy semestra. Secila lëndë vlerësohet me 6 kredite ECTS. (Ref. RVB, fq. 15-16; Kurrikula e programit).
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Kurrikula e programit dhe syllabuset disponojnë informacionin e duhur në lidhje me ngarkesën mësimore në auditor, orë pune individuale për çdo lëndë të programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Llojet e vlerësimit të studentëve janë midis semestrit, me projekte prezantime, prania, pjesëmarrja aktive, dhe provim fundor. Sipas rregullores së programit të studimit niveli i kërkuar për frekuentimin e mësimin është 80%. (Ref. RVB, fq. 15-16; Rregullore e programit).
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në program pranohen studentë që kanë kryer baçeloret në çdo fushë në universitete shqiptare ose jashtë. Kushtet dhe kriteret e pranimit dhe transferimit janë detajuar te rregullorja e programit të studimit. Këto kushte dhe kriteret në të njëjtën kohë gjenden edhe në faqen publike të internetit të universitetit. Pranimi i studentëve nga çdo fushë pengon integrimin e studentëve. Vërehet mungesa e kërkesës së lëndëve adaptuese për studentët që vijnë nga fusha të cilat nuk janë ndërlidhur me shkenca politike ose marrëdhëniet ndërkombëtare. (Ref. RVB, fq. 15-16; Rregullore e programit).
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Për çdo lëndë që është pjesë e programit, ekziston syllabus i veçantë. Programi dhe institucioni nuk ofron syllabuset në faqen e vet të internetit që të jetë lehtësisht i konsultueshëm për këdo. (Ref. RVB, fq. 15-16; syllabuset e programit; Takim me GVB).
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik	Rregullorja e programit të studimit parashikon përditësimin dhe përmirësimin e syllabuseve dhe planeve mësimore në mënyrë periodike nga ana Departamenti në konsultim me Bordin e Tregut të

miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Punës. Vërehet mungesa e një dokumenti të integruar, për shembull Guidë për Studentët dhe Stafin në formë të shkruar dhe elektronike e përditësuar çdo vit, që përmban informacionet dhe rregullat e nevojshme për programet e studimit. (Ref. Rregullore e programit; Takim me stafin akademik).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi MP Studime të Sigurisë është organizuar në dy semestra, ku një pjesë e semestrit të dytë është projektuar për praktikë profesionale dhe provimin përfundimtar ose hartimin e tezës përfundimtare. Bazuar në të dhënat e paraqitura dhe informacionin e prezantuar si dhe prezantimin e programeve mësimore, programi i studimit është organizuar në module të cilat janë të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi MP Studime të Sigurisë ka 60 kredite (ECTS) në total dhe zgjat një vit akademik, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. (Ref. RVB, fq. 16-18; Rregullore e programit; Takim me GVB).
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Në tërësi programi i studimit është orientuar për ti ofruar studentëve një specializim në fushën e politikave të sigurisë. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, por disa nga profilet (1. Çështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitikë) kanë përmbajtje më shumë teorike se sa praktike. Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. (Ref. RVB, fq. 16-18; Kurrikula e programit).
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Objektivi kryesor i programit mbetet pajisja e studentëve me aftësitë e duhura për të analizuar, kuptuar dhe interpretuar institucionet, aktivitetet dhe interesat e aktorëve kryesorë në politikat e sigurisë. Programi ka një përmbajtje të gjerë tematikash dhe ofron mundësinë jo vetëm për të krijuar një bazë solide njohurish por edhe për të specializuar studentët në fusha/profile të politikave e sigurisë për të cilat kanë interes. Programi ofron një ndërthurje lëndësh interdisiplinare duke bashkërenduar jo vetëm subjekte nga fusha e sigurisë por edhe nga ajo e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Organizimi i programit është kryer konform rregullave dhe procedurave ligjore në fuqi si përsa i takon organizimit të programit në vite akademike, semestra, dhe kredite ashtu edhe përsa i takon ngarkesës përkatëse për çdo komponent. (Ref. RVB, fq. 16-18; Kurrikula e programit; Plani mësimor i programit).
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit,	Studimet e sigurisë është një trend i ri dhe global në fushën e

lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	marrëdhëniet ndërkombëtare. Si i tillë, ajo është bazuar në eksperiencat ndërkombëtare dhe afron universitetet në Shqipëri me trendet globale. Programi i studimit përkon me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare dhe Europiane të Kualifikimit. (Ref. RVB, fq. 16-18).			
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga biseda që GVJ pati me studentët ishte e qartë se ata ishin shumë të kënaqur me metodat e mësim-dhënies që aplikoheshin në këtë program dhe me lirinë që i jepej atyre për të qenë aktivë në klasë. Në mënyrë të veçantë ata vlerësuan punën në grupe, projektet e ndryshme që bënin dhe sidomos aktivitetet në klasë të cilat i mundësonin aplikimin praktik të koncepteve teorike që përftonin në leksion. (Ref. Takime me studentët).			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Sipas rregullores së programit të studimit, stafi akademik përditëson në mënyrë periodike literaturën e lëndës. Stafi akademik bën kërkesë pranë Departamentit për literaturën e nevojshme. Struktura të tjera brenda universitetit vijnë procedurën për plotësimin e kërkesave të stafit. (Ref. Takim me stafin akademik).			
<b>Kriteri 7.</b> Përbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Kurrikula e paraqitur, trajtimi i tematikave në syllabus dhe metodologjia interdisiplinare, dëshmojnë synimet e programit për të zgjeruar më tej njohuritë e studentëve të fituara në ciklin e parë të studimeve. (Ref. Kurrikula e programit; syllabuset).			
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur. Ka një disbalancë midis lëndëve teorike dhe atyre praktike në favor të të parës. Brenda programit të studimit mund të ishte bërë një përshtatje më e ekuilibruar e lëndëve teorike dhe ato të praktike. (Ref. Kurrikula e programit).			
<b>Kriteri 9.</b> Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi MP Studime të Sigurisë mundëson një nivel cilësor në mësimdhënie. Programi mësimor ofron profilim të specializuar që mund të lehtësojë studimet e mëtejshme ose punësim në treg. Por, duhet të shtohen lëndë me zgjedhje brenda programit dhe institucionalizimi i organizimit të praktikave profesionale për studentët e programit. (Ref. Takim me studentët).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Sipas të dhënave të paraqitura nga institucioni për kualifikimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, në tërësi numri (12 staf akademik: 10 me kohë të plotë dhe 2 me kohë të pjesshme per vitin 2018-2019, dhe 8 me kohë të plotë dhe 5 me kohë të pjesshme per vitin 2019-2020) dhe cilësia e stafit akademik nga pikpamja e gradave dhe titujve është e kënaqshme dhe i përmbush e i tejkalon kërkesat ligjore. Nga informacioni i zyrës së burimeve njerëzore

	rezulton se pedagogët në përgjithësi janë të punësuar me kohë të plotë në institucion. (Ref. RVB, fq. 18-19; Takim me GVB; Personeli akademik i fakultetit, dept, programit).			
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Kualifikimi i personelit akademik është në një nivel të kënaqshëm sa i takon kualifikimit të tyre. Në këtë program një pjesë e konsiderueshme pedagogësh kanë edhe gradën e Prof. Asoc ose Profesor ndërsa pjesa e mbetur kanë gradën PhD/Dr. (Ref. RVB, fq. 18-19; Personeli akademik i fakultetit, dept, programit).			
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Bazuar te CV dhe syllabuset e lëndëve vërehet lidhje midis profilit të stafit akademik dhe lëndës për të cilën janë titullarë. Numri i botimeve dhe konferencave konfirmon punën e stafit për realizimin e programit të studimit. (Ref. Syllabuset; CV- të e stafit akademik; Takim me stafin akademik).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Studentët monitorohen nga pedagogët e brendshëm në praktikat profesionale dhe në tezat përfundimtare. Në rastin e organizimit të praktikave profesionale gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se personeli akademik është i mjaftueshëm për këtë mbikëqyrje, duke patur parasysh raportin ndërmjet studentëve praktikantë dhe pedagogëve të programit. (Ref. Takim me GVB).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni angazhon personelin ndihmës për mirëmbajtjen e infrastrukturës, laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore. (Ref. Takimet me GVB dhe stafi akademik).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga	Në UET u vërejt prania e një plani strategjik 2015-2020 të vetë institucionit i cili synon rritjen e cilësisë së programeve. Në planin strategjik, UET paraqet procedurat dhe planet për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxëniet dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Përpjekjet e institucionit për harmonizimin e programit të studimit me tregun e punës (për

<p>tregu i punës.</p>	<p>shembull Bordet e Tregut të Punës) ka bërë të mundur që të trajtohen në nivelet e duhura sfidat që kanë të bëjnë për përmirësimin e mësimdhënies. (Ref. Plani Strategjik; Takim me Takim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve).</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët në përgjithësi janë përfshirë te Bordi i Tregut të Punës dhe te fokus grupet e Departamentit. Në departament zhvillohen aktivitete nëpërmjet klubet studentore. Në kuadër të aktiviteteve ekstrakurikulare në forumet UET janë të ftuar personalitete që kanë zhvilluar leksion të hapur me studentët. Por, vërehet aktivizimi i kufizuar i studentëve në aktivitetet kërkimore, administrative, dhe mësimore. Përfshirja a studentëve të MP si ndihmës/asistent për të ndihmuar pedagogët në procesin mbështetës mësimor mund të jetë një mjet i përfshirjes së studentëve. Kjo do të ishte edhe një mënyrë e mirë për t'i dhënë studentëve eksperiencë pune. Gjithashtu studentët mund të përfshiheshin, sipas mundësive dhe aftësive, në projekte kërkimore të pedagogëve, në projekte kërkimore të fituara nga institucioni si në rang departamenti ashtu edhe në rang institucioni. Duke patur parasysh se ky është një program ku pjesëmarrja e studentëve në punën praktike është e nevojshme, institucioni mund të zhvillojë një politikë të tijën efektive për përfshirjen e studentëve në jetën e departamenteve dhe aktiviteteve të tyre shkencor. (Ref. Takim me GVB).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>UET ka një zyrë të veçantë për marrëdhëniet me studentët e diplomuar ose alumni. Zyra është angazhuar në organizimin e aktiviteteve që kanë për qëllim përfshirjen e alumni në punën e institucionit. Alumni marrin pjesë aktive në strukturat konsultuese e universitetit, sic janë Bordet e Tregut të Punës. (Ref. RVB, fq. 19-20; Takime me Takim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Programi i studimit është i vetmi program në Shqipëri që është dedikuar për fushën e politikave të sigurisë. Mbetet nevoja për më shumë bashkëpunim me institucionet e politikave të sigurisë të vendit (Ref. RVB, fq. 19-20).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së</b></p>
--

**mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>				
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UET përdor disa mjete për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ndër të tjera, institucioni organizon trajnime të personelit akademik me fokus metoda në mësimdhënie. Stafi, njëkohësisht merr pjesë në aktivitete, trajnime dhe konferenca që nxisin përmirësimin e mësimdhënies. Institucioni po ashtu ka hartuar udhëzues për standartizimin e syllabuseve, këshillimit akademik, etj. (Ref. RVB, fq. 21-22; Takim me Takim me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).</p>				
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Vlerësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i mësimdhënies nga zyrat menaxheriale ose nga zyrat e dedikuara për garantimin e cilësisë dhe nga vetë studentët është një praktikë shumë e rëndësishme. Në nivel fakulteti, dekani, dhe në nivel departamenti, shefi i departamentit ose përgjegjësit të grup-lëndëve, ndjekin vetë disa orë leksioni në auditor për të matur cilësinë e mësimdhënies. (Ref. Takim me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët në fund të çdo semestri vlerësojnë pedagogun dhe lëndën nëpërmjet sistemit online LMS. Njëkohësisht, vlerësimi i mësimdhënies bëhet përmes fokus grupeve dhe mbledhjeve të hapura që departamenti organizon me stafin dhe studentët. Studentët kanë të drejtë të shprehin ankesat e tyre pranë Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit ose pranë Përgjegjësit të Departamentit. Për të siguruar që ka një përgjigje ndaj ankesave të studentëve, sugjerimi i GVJ është që ankesat e studentëve të paraqiten vetëm pranë Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit. GVJ konstaton se institucioni ka ngritur dhe institucionalizuar sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (KSBC). (Ref. RVB, fq. 21-22; Takim me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vërehet mungesa e publikimit për publikun më të gjerë të rezultateve dhe analizave semestrale ose vjetore të vlerësimeve online të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Një ndër mënyrat e publikimit të rezultateve mund të jetë hartimi nga KSBC i raportit vjetor të vlerësimit të brendshëm dhe publikimit të tij në faqen e internetit të institucionit. (Ref. RVB, fq. 21-22; Takim me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Plani strategjik i universitetit 2015-2020 nxit përmirësimin konstant të cilësisë së mësimdhënies. Zyra e cilësisë (KSBC), fakulteti, departamenti, dhe grupet e formuara sipas lëndëve inkurajon rritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies. Duke qenë se dhe studentët dhe stafi janë të përfshirë në procesin e matjes së brendshme të cilësisë, bazuar dhe tek vizita në institucion, GVJ vërejt se të dyja palët ishin të mirë informuara mbi këtë proces. Në planin strategjik të institucionit mungon analiza dhe objektivat e veçantë dedikuar kontrollit të brendshëm të cilësisë që synon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies e të mësimdhënies. (Ref. Plani Strategjik).</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="566 1960 710 2033">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="710 1960 933 2033">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="933 1960 1141 2033">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1141 1960 1361 2033">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

standardit			X	
------------	--	--	---	--

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Mësimi në programin e studimit zhvillohet pasdite për t'i dhënë mundësi studentëve të punësuar që të ndjekin lirisht leksionet. Normalisht një lëndë zgjat 3 orë. Gjithashtu, zhvillohen edhe praktikat profesionale, projekte, seminare dhe leksione të hapura me ekspertë të fushave të ndryshme. (Ref. RVB, fq. 22-24; Takimet me GVB dhe me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Duke qenë se programi ka numër të vogël studentësh, numri i studentëve në klasë është ideal për të bërë punë në grup dhe për t'i dhënë vëmendje individuale studentit. Nga biseda që patëm me studentët ishte e qartë se ato ishin të kënaqur me metodat e mësimdhënies që aplikoheshin në këtë program dhe me lirinë për të qënë aktiv në klasë. Në mënyrë të veçantë studentët vlerësuan praktikat profesionale, punën në grupe, projektet e ndryshme që bënin dhe sidomos aktivitetet në klasë që i mundësonin aplikimin praktik të koncepteve teorike të marra në leksion. Duke marrë parasysh faktin që në program pranohen studentët nga të gjitha fushat, lind nevoja për përshtatjen e leksioneve sipas njohurive të studentëve. (Ref. Takimet me GVB dhe me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Për këtë, përveç kontrolleve të herë pas herëshme, institucioni zhvillon edhe trajnime me trajnues të brendshëm ose të jashtëm (Dita e Zhvillimit të Stafit) për të rritur nivelin dhe metodikën e mësimdhënies në institucion. Njëkohësisht, stafi përfiton nga programet e shkëmbimit me universitetet partnere që mundëson shkëmbim të eksperiencave dhe njohurive në fushën e transmetimit të dijes. Pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimi i kërkimit shkencor nga stafi akademik mundësojnë përmirësimin e mësimdhënies. (Ref. RVB, fq. 22-24; Takim me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulaveinstitucioni).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Nga shqyrtimi i CV-ve të pedagogëve të programit të studimit dhe nga biseda që GJVJ pati me pedagogët vërehen kompetencat e duhur akademike dhe profesionale e stafit akademik. (Ref. RVB, fq. 22-24; CV të pedagogëve).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sistemi institucional i vlerësimit të mësimdhënies (vlerësimi online nga studentët, fokus grupet, etj) mundëson përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies. (Ref. Takim me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulaveinstitucioni).



<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Normalisht leksionet zhvillohen më metoda interaktive (diskutime, raste studimore, puna në grupe, prezantimet, etj) dhe duke u bazuar edhe në mundësitë teknologjike që ofron universiteti. (Ref. RVB, fq. 22-24; Takimet me GVB dhe stafi akademik).			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Përgjithësisht në leksione dhe seminare përdoren 'case studies' dhe metoda të tjera ku studenti është pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor përmes zhvillimit të mendimit kritik. Prezantimi në grup i detyrave kultivon bashkëpunimin midis studentëve dhe mësimin nga njëri-tjetri. (Ref. RVB, fq. 22-24; Takimet me GVB dhe stafi akademik).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Bazuar në RVB por edhe në vizitën në institucion, GVJ vlerëson se kushtet infrastrukturore në të cilat zhvillohet mësimi në UET janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit në kuadër të akreditimit të tij. Specifikisht, UET ndodhet në qendër të Tiranës dhe godinat e universitetit shtrihen në një sipërfaqe totale prej 8600 m <sup>2</sup> . GVJ, konstatoi se viti akademik 2019-2020 po zhvillohej rregullisht pas tërmetit të 26 Nëntor 2019 në mjediset e tre godinave me sipërfaqe totale 11500 m <sup>2</sup> . Përgjatë vitit akademik 2019-2020, UET ofron 33 salla mësimore (leksione dhe seminare), dhe 3 laboratorë kompjuterikë. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Universiteti ofron edhe sistem wireless në të gjitha mjediset e tij. Të gjitha klasat ishin të pajisura me mjete didaktike si dhe me teknologjinë moderne që mundëson një mësimdhënie interaktive. Gjithashtu, studentëve u ofrohen një sërë lehtësirash të tjera infrastrukturore dhe teknologjike për zhvillimin e procesit mësimor. Vërehet mungesa e një sallë konferencash. (Ref. RVB, fq. 24-26; Dokumenti - Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit; Vizita në ambjenteve të institucionit).
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	GVJ vlerëson se numri dhe logjistika e klasave, laboratorëve dhe zyrave është i mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit. Ky program mësimor nuk ka të nevojshme praktika në laborator. Praktikant profesional të programit përgjithësisht zhvillohen jashtë ambjenteve të universitetit. (Ref. Vizita në ambjenteve të institucionit).
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të	Studentët dhe stafi akademik punojnë në mjediset funksionale dhe kanë në dispozicion një gamë të gjerë teknologjike. Të gjitha sallat

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	mësimore janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. (Ref. RVB, fq. 24-26; Dokumenti - Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit; Vizita në ambjenteve të institucionit).
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	UET ka gjithashtu edhe një bibliotekë me një sipërfaqe totale prej 300 metra katror. Fizikisht, biblioteka, ka një total prej 6071 librash të shtypur, çdo pedagogë mund të bëjë kërkesë pranë Departamentit për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të leksioneve. (Ref. RVB, fq. 24-26; Dokumenti - Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit; Vizita në ambjenteve të institucionit).
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Gjatë vizitës të GVJ në Bibliotekë, u vërejt se Biblioteka është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve në programin e studimit. Literatura është e bollshme me botime. Biblioteka ka nëndarjen e saj të lidhur me funksionin e programit të studimit. Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti wireless. Përdorimi i Bibliotekës është kushtëzuar me regjistrimin në Bibliotekë; çdo student ose stafi duhet të ketë akses direkt në përdorimin e bibliotekës me kartën studentore ose stafit. (Ref. Vizita në Bibliotekë).
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka është e pajisur me 12 PC dhe sistem wireless në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online. UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). UET është abonuar gjithashtu në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia, biblioteka dixhitale që përmbajnë revista akademike të cilat mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. (Ref. RVB, fq. 24-26; Vizita në Bibliotekë).
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Ky program studimi nuk ka të nevojshme praktika në laborator. Megjithatë, laboratorët e informatikës janë të pajisura me PC dhe me programet e nevojshme për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. (Ref. Vizita në ambjenteve të institucionit).
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxiti personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	UET përdorë sistemin MOODLE (UET LMS), që bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet didaktike të hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio-vizive etj. (Ref. RVB, fq. 24-26; Takim me stafin akademik).
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.	Specifikisht, Sistemi i Menaxhimit të Mësimimit (LMS) është një shërbim i bazuar në Moodle që iu ofrohet studentëve dhe pedagogëve me qëllim aksesin, koordinimin dhe organizimin në internet të materialeve të lëndëve. Studentët dhe pedagogët mund të futen në LMS me anë të e-mailit zyrtar që iu jepet. (Ref. RVB, fq. 24-26; Takim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve).
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Departamenti dhe stafi akademik mbështet dhe jep udhëzime studentëve në selektimin dhe zhvillimin e temave të diplomës. Në rastin e këtij programi studentët në përfundim të vitit akademik 2018 – 2019 mbrojtjen finale e realizuan me provim me “Rast studimor kompleks”. (Ref. RVB, fq. 24-26; Takimet me GVB dhe stafi

	akademik).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është njësi autonome në nivel institucional që merret me sigurimin e cilësisë së brendshëm të UET. KSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme. (Ref. RVB, fq. 27-28; Takim me KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia bazë (Departamenti) në radhë të parë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies. Në takimet që GVJ pati në institucion vuri re vetëdijen e lartë të personelit menaxherial, stafit akademik, dhe të studentëve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. (Ref. Takim me GVB).
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Stafit akademik i është dhënë liria në zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie. KSBC propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme. (Ref. RVB, fq. 27-28; Takim me KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga RVB dhe dokumentacioni bashkangjitur është e qartë se stafi akademik i departamentit që ofron programin është aktiv në realizimin e botimeve akademike. Stafi ka marrë pjesë në konferenca dhe ka botuar artikuj shkencorë dhe kapituj në libra të edituar. Nga analiza e RVB-së, dokumentave plotësuese të vëna në dispozicion nga institucioni si dhe nga takimi me stafin drejtues dhe pedagogët u bë e qartë se institucioni i kushton një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor cilësor dhe botimeve në medime serioze dhe prestigjioze akademike. Institucioni ka mekanizma për të kontrolluar, promovuar si dhe shpërblyer punën kërkimore të stafit si instrumente për përmirësimin e punës dhe rritjen e standardeve. Gjithashtu, institucioni bënë përpjekje maksimale që të lidhë në mënyrë organike kërkimin shkencor dhe ekspertizën kërkimore me mësimdhënien në programin e studimit nën analizë. Ka një numër të kufizuar të botimeve në fushën e studimeve të sigurisë dhe vetëm 1 botim në revistë të indeksuar Scopus. Sugjerohet fillimi i një projekti hulumtues në fushën e studimeve të sigurisë që mund të kontribuojë në përfshirjen e pedagogëve të programit të studimit në shkencën ndërkombëtare në fushën e studimeve të sigurisë. Nga analiza e RVB-së dhe dokumentacionit u vu re që në fakultetin ku ofrohet programi i studimit ka nevojë edhe për një qendër kërkimi me qëllim mbështetjen e stafin në kërkimin shkencor. Gjithashtu, me vlerë do të ishte që institucioni të

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	mbështesë anëtarët e stafit akademik në realizimin e kërkimit shkencor me anë të një sistemi të mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. (Ref. RVB, fq. 27-28; Takimet me GVB dhe stafi akademik).			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Institucioni organizon trajnime për përmirësimin e aftësive të stafit akademik. Ata marrin pjesë edhe në shkëmbimin e eksperiencave në universitete partnere në kuadrin e programit Erasmus +. (Ref. RVB, fq. 27-28; Takim me KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Nga takimi me pedagogët ishte e qartë se ata gëzojnë lirinë dhe autonominë në implementimin e metodave të reja në mësimdhënie. (Ref. Takim me stafin akademik).			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Rishikimi i vazhdueshëm i syllabuseve, organizimi i mbledhjeve të departamentit, trajnimet, dhe vlerësimet nga studentët ose nga ana e zyrave menaxheriale, mundësojnë reflektimin mbi rezultatet e përdorimit të metodave të reja në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. (Ref. RVB, fq. 27-28; Takim me KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave).			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Konferenca, leksione të hapura, dhe forume organizohen shpesh në UET si pjesë e procesit të mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës. Gjithashtu, përfshirja e profesorëve të huaj në kuadrin e programit Erasmus + mundëson shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies. (Ref. RVB, fq. 27-28; Takim me GVB dhe stafi akademik).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton mënyrat e vlerësimit të punës së studentëve. Vërehet që në këtë Rregullore sikundër dhe në shumë dokumente të tjera të institucionit nuk është paraqitur data kur dokumenti është pranuar dhe miratuar nga institucioni. Gjithashtu, vërehet që rregullorja e programit të studimit është e aksesueshme vetëm për studentët dhe stafit, por jo për publikun më gjerë. (Ref. RVB, fq. 29; Rregullore e programit).
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i	Studentët njoftohen në fillim të çdo semestri për format dhe sistemin e vlerësimit nga pedagogu i lëndës. Syllabusi përmban detajet e vlerësimit të dijeve. Studentët informohen edhe nëpërmjet platformës LMS. Por, vërehet që syllabuset e lëndëve të programit të studimit janë të aksesueshme vetëm për studentët dhe stafit, por jo për

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

lëndës/modulit.	publikun më gjerë. (Ref. Syllabuset; Takim me studentët).			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në RVB-në e programit por edhe nga bisedat që patëm në institucion, vlerësimi ishte i ndarë dhe i shpërndarë në mënyrë të arsyeshme gjatë gjithë semestrit. Programi ofron një varietet të gjerë formash vlerësimi për studentët. Llojet e vlerësimit të studentëve janë midis semestrit, seminare, projekte prezantime, pjesëmarrja aktive, dhe provimi final. (Ref. RVB, fq. 29; Takim me studentët).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi është i shpërndarë gjatë gjithë semestrit për t'i dhënë mundësi studentit që të jetë aktiv dhe i angazhuar sa më gjatë. Kjo praktikë rrit dëshirën dhe mundësitë e studentëve për të qenë të suksesshëm, të përgatitur në vazhdimësi. (Ref. RVB, fq. 30-31; Rregullore e programit; Takimet me GVB dhe stafi akademik).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UET, së fundmi përdor një sistem të ri vlerësimi elektronik: "clean scoring". Ky sistem mundëson vlerësimin elektronik të tezave të studentëve gjithashtu garanton transparencë në procesin e vlerësimit të studentëve. (Ref. RVB, fq. 30-31; Takimet me GVB dhe Sekretarinë mësimore).
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi me komision bëhet vetëm për praktikat profesionale dhe punimin e diplomës/provimit të përgjithshëm përfundimtar. (Ref. RVB, fq. 30-31).
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Provimet me shkrim (i ndërmjetëm dhe përfundimtar) zhvillohen në mënyrë anonime me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit dhe çdo provim monitorohet nga dy pedagogë. (Ref. RVB, fq. 30-31; Takimet me GVB dhe studentët).
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Institucioni parashikon që çdo vlerësim i provimeve të shoqërohet me argumentet përkatëse nga ana e pedagogut. (Ref. RVB, fq. 30-31).
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në bisedat që GVJ pati në institucion, egzistojnë sfida për parandalimin e kopjimit në provime. Megjithatë njësitë përgjegjëse të institucionit janë të angazhuara të mos e tolerojnë kopjimin në provime dhe në detyra me anë të monitorimit të zhvillimit të provimeve, ndalimi i përdorimit të telefonave celularë gjatë provimeve, etj. Egziston nevoja për të luftuar pandëshkueshmërinë e studentëve për plagjiaturë. (Ref. Takimet me GVB, stafi akademik)

	dhe studentët).			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e programit të studimit përcakton 2 (dy) javë si afat për dorëzimin e vlerësimeve të provimeve nga data e zhvillimit të tyre. Bazuar në bisedat që GVJ pati me Sekretarinë Mësimore të institucionit, ky afat respektohet nga ana e pedagogëve. (Ref. RVB, fq. 30-31; Takim me GVB; Rregullore e programit).			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Student kanë të drejtën për seanca sqaruese me pedagogun përkatës dhe gëzojnë të drejtën e ankimit pranë Departamentit. Këto të drejta janë përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit. (Ref. RVB, fq. 30-31; Rregullore e programit).			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Departamenti mund të ngrejë një komision në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit. (Ref. RVB, fq. 30-31).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit MP Studime të Sigurisë është organizuar me lëndë bazë (Metoda kërkimi të avancuara) dhe karakterizuese (Çështje të sigurisë ndërkombëtare, Politikë e jashtme e krahasuar, Çështje të strategjisë ndërkombëtare), dhe me pesë profile të ndryshme. Kjo jep mundësi për thellimin njohurive dhe aftësive në fushën e politikave të sigurisë. (Ref. RVB, fq. 32-34; Plani mësimor).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit veçanërisht tek profili 4 - Siguria e sistemeve të informacionit jep mundësi për thellimin e njohurive dhe aftësive në fushën e informacionit nga perspektiva e studimeve të sigurisë. Programi gjithashtu vë theks tek aftësitë humane dhe sociale. (Ref. RVB, fq. 32-34; Kurrikula e programit).
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Bazuar në bisedat që GVJ pati në institucioni, pedagogët në orën e fundit të mësimit i përkushtohen trajtimit për përmbledhjen e koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara gjatë semestrit. (Ref. Takimet me GVB dhe studentët).
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Pedagogët në orën e fundit të mësimit njëkohësisht japin orientimet e nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provimin përfundimtar ose në punimin e diplomës. (Ref. RVB, fq. 32-34; Takimet me stafin akademik dhe studentët).
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i fuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë	Në kuadër të praktikave profesionale, projekteve, seminareve dhe leksioneve të hapura me ekspertë të fushave të ndryshme informojnë studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit në fushën e

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

jashtë strukturës së programit të studimit.	politikave të sigurisë. (Ref. RVB, fq. 32-34; Takimet me stafin akademik dhe studentët).			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Studentët e programit mund të ndërtojnë aftësitë e tyre gradualisht, duke filluar nga lëndë teorike, dhe pastaj me anë të praktikave profesionale që janë të detyrueshme për studentët e programit. (Ref. RVB, fq. 32-34; Takimet me stafin akademik dhe studentët).			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Bazuar në bisedat që GVJ pati me pedagogët, ata aplikojnë metodat e punës në grup dhe diskutimet si pjesë e mësimdhënies. (Ref. Takimi me stafin akademik).			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Për shkak të faktit se studimet janë të kufizuara në kohëzgjatje për një vit, programi i studimit nuk ofron shumë mundësi për kërkim shkencor. (Ref. RVB, fq. 32-34).			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Bazuar në RVB dhe vizitën e kryer në institucion, nuk ka informacion që institucioni ofron ndihmë financiare për projekte kërkimore të studentëve. (Ref. RVB, fq. 32-34; Takimet me GVB dhe studentët).			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Numri i mobiliteteve nga universiteti është në rritje në kuadër të projekteve Erasmus +. Lëvizshmëria e studentëve inkurajon stafin që të kombinojë elementet ndërkombëtare në mësimdhënie. (Ref. RVB, fq. 32-34; Takim me stafin akademik).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Struktura përgjegjëse për zhvillimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale është departamenti i cili garanton realizimin e praktikës profesionale si për orët në auditor, dhe në orët e zhvilluara në institucionet pritëse. Pedagogu mbikqyrës ndjek procesin e praktikës. (Ref. "Mbi praktikën profesionale" pika B.I.3 dhe B.I.3.I; Takimi me GVB, takimi me studentët)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Institucioni punon që të garantojë praktika profesionale efektive duke mundësuar ndërthurjen e njohurive me aftësimin praktik. (Ref. RVB, fq. 34, Takimi me studentët fq.17)
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Në planin mësimor, praktika profesionale ka 6 kredite. Me përfundimin e praktikës dhe përmbushjen e detyrimeve sipas pikës B.I.7.7 dhe B.I.8 realizohet vlerësimi përfundimtar i studentit para komisionit të vlerësimit. (Ref. "Mbi praktikën profesionale", Takimi me GVB)

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.9

#### Institucioni ndjek një procedurë të qartë diplomimi të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në nivel institucioni, Universiteti ka një dokument të cilësuar: “Mbi punimin e diplomës/disertacionit” B.II i cili kategorizohet si “manual procedure” dhe përshkruan procedurën e posaçme vetëm për realizimin e diplomës dhe mbrojtjes së saj. Gjatë vitit 2018-2019, është ndjekur për të gjithë studentët e këtij masteri mbrojtja me provim të përgjithshëm përfundimtar e konceptuar si një “rast studimor kompleks”. Nuk ka një procedurë sesi realizohet konkretisht ky proces madje në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të dytë, master profesional “Studime të Sigurisë” cilësohet vetëm si alternativë PPP (provimi përfundimtar i përgjithshëm (pika 7 e Rregullores) dhe përcaktimin në rregullore të kriterit të mesatares. (Ref. B.II; RVB; Rregullorja e Programit të Studimit)
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse brenda departamentit kujdesen që studentët të orientohen në lidhje me literaturën përkatëse dhe të marrin gjithashtu orientime mbi shembujt e rasteve studimore që duhet të kenë në konsideratë për referim. (Ref. RVB, fq.35; Takimi me GVB; Takimi me studentët)
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Forma e testimit për provimin përfundimtar sipas RVB është me rast studimor kompleks. Sikundër cilësohet në raport: “Ritestimi teorik i njohurive është gjykuar i papërshtatshëm për një program të llojit Master Profesional” kjo çështje u trajtua dhe në takim me anëtarët e GVB duke pohuar se struktura e rastit kompleks studimor përfshinte ndërthurjen e njohurive të marra nga lëndët bazë të profilit të konkretizuara në një rast studimor. (Ref. Takimi me stafin akademik)
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Përmbyllja e studimeve në programin e studimit MP “Studime të Sigurisë” për vitin 2018-2019 për të gjithë studentët është bërë me provim përfundimtar të përgjithshëm me “Rast Studimor Kompleks”. Institucioni ka procedure të përcaktuara për përfundimin e studimeve me temë diplome por për këtë master nuk është ndjekur kjo formë e përmbjlljes së studimeve.(Ref. RVB, fq.35-36, Takimi me GVB)
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti	Provimi përfundimtar i përgjithshëm vlerësohet me notë e cila është rezultatja e mesatares së vlerësimit nga anëtarët e komisionit

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



vlerësohet me notë.	të vlerësimit. (Ref. RVB, fq.36)			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti pajiset me diplomë pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike dhe kontraktuale me UET. Brenda 6 muajve institucioni ka detyrimin ta pajisi studentin me diplomë, suplement dhe çertifikatë notash. (Ref. RVB, fq.36; Rregullore UET neni 41)			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në rast të kërkesës nga ana e studentit, institucioni e mundëson një gjë të tillë (Ref. RVB, fq.37)			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Institucioni ruan për një periudhë pa afat një kopje të dokumentacionit të studentit. (Ref. RVB, fq.37; Takimi me punonjëset e sekretarisë mësimore)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT.

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	Në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2018-2019 numri i stafit akademik i angazhuar ishte 12, ku 10 ishin staf akademik me kohë të plotë dhe 2 me kohë të pjesshme. Pranë zyrës së burimeve njerëzore është i depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar. (Ref. Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP Studime të Sigurisë; Takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore.)
<b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar pika G.I “Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik” në dokumentin G. Rregullore për Burimet Njerëzore, i cili përcakton zhvillimin e procesit.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e	Evidentimi i nevojave për staf akademik realizohet nga

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Departamenti, i cili përcjell nevojat specifike për lëndë të caktuara në Dekanat dhe pas miratimit tek strukturat e burimeve njerëzore vijojnë procedurën e shpalljes në njoftimit në faqen zyrtare të universitetit, rrjeteve sociale dhe gazetën Liberale. (Ref. pika G.I.6 tek dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore; Takimi me Pergj.Dep; RVB)			
<b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurat e përcaktuara në dokumenta si Rregullorja e UET dhe Rregulloren për Burimet Njerëzore duke iu përmbajtur nevojave për staf akademik sipas profileve të kërkuara nga njësitë bazë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Mjediset e vendosura në dispozicion për stafet e departamenteve janë gjithsej 8 ambiente me sipërfaqe 45m secila, 10 ambiente zyrash me nga 18m janë për përgjegjësat e departamenteve dhe 6 ambiente me nga 14m janë zyra për koordinatorët. Ambjentet e punës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e stafit akademik. (Ref. vizita në institucion; Dok. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit fq.2)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni realizon disa incentive të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete si dhe përmes skemës së financimit të kërkimit shkencorë me një fond në dispozicion prej 75.000 euro për botime të artikujve shkencor të indeksuara në Thomson-Reuters. (Ref. Takimi me stafin akademik, Takimi me Dekanin dhe Pergj. Dep; RVB)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Universiteti inkurajon përmes përfshirjes së stafit akademik në projekte kërkimore me partnerë ndërkombëtar, programet Erasmus etj, mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. (Ref. Dok “Të dhënat mbi shkëmbimet e stafit”, “Angazhimi në projekte dhe SHSA”, RVB, fq.39)
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të	Stafi i angazhuar në programin e studimit MP Studime të Sigurisë me 5 profile është me tituj dhe grada në fushën e programit të ofruar. Për vitin 2019-2020 ky program studimi mbulohet nga 5 Profesor Doktor, 2 Profesor të Asociuar dhe 6 Doktor Shkencash.

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

studimeve të ciklit të dytë.	Profesionalizmi dhe kualifikimi i tyre mundëson përmbushjen e objektivave të programit. (Ref. Takimi me studentët, Dok shtesë "Personeli akademik i fakultetit, dept, programit fq.2)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Studentët e programit MP Studime të Sigurisë kanë në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit të programit të studimit. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh. (Ref. Dok. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit; Takimi me Pergj.Dep, Takimi me studentët, Vizita në institucion)			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Auditorët janë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektor, internet dhe foni. Infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor për programin MP Studime të Sigurisë garanton realizimin e procesit mësimor. Përdorimi nga ana e studentëve dhe stafit akademik të sistemit LMS (Sistemi i Menaxhimit të Mësimit) krijon infrastrukturën didaktike të aksesueshme në çdo kohë. (RVB, fq.40, LMS-Guidë për pedagogun; LMS-Guidë për studentët; takimi me stafin akademik dhe studentet).			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Institucioni ka laborator të teknologjisë së informacionit, por për natyrën që ka ky program studimi nuk është i nevojshëm përdorimi i tij. (Ref. Vizita në institucion).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Kapacitetet e UET dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. (Ref. Takimi me stafin akademik, Vizita në institucion).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.4</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në nivel universiteti është një bibliotekë e vendosur në godinën C me një sipërfaqe 300m2 me rreth 6071 libra fizik e pajisur me 12 PC dhe sistemi wireless. Institucioni garanton të drejtën e studentit për aksesimin e bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe jashtë ambjenteve të saj. (Ref. Vizita në Bibliotekë).			
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka rreth 6071 tituj librash fizik dhe ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Seksioni i titujve fizik dedikuar Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike mundëson literaturën e nevojshme për studentet e MP Studime të Sigurisë. (Ref. RVB, fq.41; Vizita në Bibliotekë)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë është pa pagesë. (Ref. Vizita në Institucion, Biblioteka)			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Në ambjentin e bibliotekës ndodhen 12 PC që janë në dispozicion të studentëve. UET është gjithashtu abonuar në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia, biblioteka dixhitale që përmbajn revista akademike të cilat mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. (Ref. RVB, fq 41-42, Vizita në ambientet e Bibliotekës dhe takimi me punonjësen e Bibliotekës.)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga stafi akademik me titujt e literaturës që duhet për lëndët që ata mbulojnë i përcjellin më tej në Dekanat duke iniciuar procedurën. Nga takimi që patëm me stafin akademik na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e tyre për literaturë plotësuese. (Takimi me stafin Akademik; RVB, fq.42)			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 09.00-20.00 dhe ditën e shtunë qëndron e hapur deri në orën 17.00.(Ref. RVB, fq.42)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET ka një sistem të menaxhimit të informacionit të quajtur UMIS. Ky program informatik realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit. (Ref. Takimi me antarët e GVB, takimi me stafin akademik; Manuali i përdorimit të sistemit UMIS)								
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Platforma UET-LMS mundëson komunikimin, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. (Ref. Takimi me Studentët; Takimi me Stafin Akademik dhe GVB)								
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit që përdoret nga UET mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentet sipas programeve të studimit. Përmes sistemit UMIS dhe platformës UET-LMS institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve, stafit. GVJ pati mundësi të shikonte funksionimin e sistemit përmes aksesit nga një anëtare e GVB. Përmes përdorimit në nivel institucional të këtij sistemi realizohet gjithashtu monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik. (Ref. RVB, fq.43-44, takimi me antarët e GVB)								
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.									
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.									
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe									
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen zyrtare të Universitetit Europian të Tiranës informacioni ofrohet vetëm në gjuhën Shqipe. Në faqen zyrtare gjendet informacion në lidhje me programin e studimit personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme. Sygjerohet që faqa zyrtare e Universitetit të jetë dhe në gjuhën angleze. (Ref. RVB, fq.44)								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit	GVJ bazuar në RVB dhe takimin në institucion me përfaqësues të zyrës së financës u informua se raporti financiar hartohet në nivel institucioni dhe nuk është i ndarë sipas programeve specifike. Për këtë program studimi nuk kishte një raport financiar të kostove. (Ref.

për të paktën një cikël të plotë studimi.	RVB; Takimi me zyrën e financës)			
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një progra studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line dhe detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zë të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional. GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se për shkak të natyrës, funksionimit dhe organizimit të UET (përfshirjes së stafit në disa programe studimi) nuk është e mundur hartimi i raporteve në bazë programi. (Ref. RVB; Takimi me zyrën e financës)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Bazuar në RVB fq.45, UET ka raporte auditimi çdo vit. Ky raport hartohet nga audituesi ligjor i pavarur E.E.I shpk në lidhje me situatën financiare, performancën, bazuar në standardet Kombëtare të Kontabilitetit.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në nivel institucioni raportet janë periodike, të përvitshme. Për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar. (Ref. Takimi me zyrën e financës)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të zyrës së financës, u informua se pavarësisht numrit të ulët të studentëve në vitin akademik 2019-2020 institucioni ndjek politikën e mbështetjes të programeve të studimit për një periudhë 2-3 vjeçare derisa programi të fuqizohet. Kjo gjë mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndëruar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucioni. (Ref. Takimi me zyrën e financës; dok "Të dhënat për studentët MP Studime të Sigurisë)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe**

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafá», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<b>diplomimin në programin e studimit</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ-së iu bë me dije se Universiteti Europian i Tiranës, realizon pranime në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Senatit. Për programet e studimit me karakter profesional nuk janë aplikuar kritere shtesë përtej kritereve ligjore.(Ref. RVB, fq.46; Faqa zyrtare e universitetit, <a href="https://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/?lang=sq">https://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/?lang=sq</a> )			
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyruar Statutit UET, Rregullore e Programit MP Studime të sigurisë rezulton se politikat dhe procedurat e ndjekura nga UET përsa i takon pranimit dhe përfundimit të studimeve janë të njëjta për të gjithë studentët. (Ref. Statuti UET, neni 32, 37, 50; Rregullore e Programit MP Studime të sigurisë)			
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Studentët kanë mundësi që të aksesojnë këto kritere dhe procedura si nga faqa zyrtare e UET dhe nga interneti. (Ref. RVB, fq.46)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Përmes vendimeve të Senatit Akademik të UET institucioni vendos për kritere shtesë krahas atyre të përcaktuara nga Udhëzimi i Ministrisë. Ky vendim është i aksesueshëm. Ai publikohet në faqen zyrtare të universitetit. (Ref. RVB, fq.47; WEB - UET)			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. (Ref. dok: “Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve” dhe “Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e	Gjatë vizitës në institucion GVJ pa nga afër përdorimin nga ana e stafit akademik të platformave UMS dhe LMS. Përmes këtyre platformave, institucioni mundëson një informacion dhe njohjen e

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	përparimeve akademike nga studentët në kohë reale. Gjithashtu, krahas sekretarisë mësimore është dhe koordinatori i programit i cili bënë të mundur dhënien e informacionit gjithashtu.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni ka një rregullore mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin ku bazohet realizimi i procedurës dhe informim i studentëve mbi këto procese. (Ref. RVB, dok “Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët, gjithashtu në fillim të çdo semestri ata informohen dhe nga stafi akademik mbi procedurat e vlerësimit të dijeve. (Ref. Takimi me stafin akademik; RVB, fq.47-78)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni organizon seanca informimi mbi punimin e diplomës. Në këtë master është ndjekur procedura e provimit me “Rast studimor kompleks”. GVJ u informua nga takimi me anëtarët e GVB se studentët janë udhëzuar mbi literaturën dhe formatin e testimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Nga shqyrtimi i RVB dhe takimi me stafin akademik rezulton se institucioni organizon në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit”, gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Institucioni ka disa forma të informimit; online ose përmes zyrës së kujdesit të studentit, stafit akademik etj. Këto struktura mundësojnë informacion në lidhje me strukturën dhe organizimin e programit të studimit. (Ref.RVB, fq.48)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes platformës LMS dhe stafit akademik që realizon programin. (Ref. Takimi me stafin akademi; takimi me student; RVB, fq. 48)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon panairë të tregut të punës si dhe ka strukturën e bordit të tregut të punës që mundëson lidhjen e studentëve të punësuar me universitetit. Gjithashtu zyra e Këshillimit të Karrierrës dhe Kujdesit të Studentëve bënë njoftime për mundësi punësimi. (Ref. RVB, dok “Poster panairi i punës”
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i	Në takimin e realizuar me studentët e programit MP Studime të

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Sigurisë u vërejt fakti se ata vlerësonin sistemin LMS. Sipas studentëve, sistemi u krijonte shumë lehtësi në komunikimin me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar në vitin akademik 2018-2019 ( 25 studentë të regjistruar) dhe vitin aktual që vijojnë studimet në programin MP Studime të Sigurisë janë 4 studentë. (Ref. dok “Të dhëna për studentët MP Studime të Sigurisë)			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Të diplomuar janë 18 studentë, të çregjistruar 4 studentë dhe aktiv akoma 3 studentë. Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin MP Studime të Sigurisë. (Ref. Takimit me Sekretarinë Mësimore)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni disponon për çdo student dosjen me të gjitha të dhënat që nga momenti i fillimit të programit dhe deri në përfundimin e tij. (Ref. Takimi me Sekretarinë Mësimore; RVB, fq.49)			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni përmes sistemit UMIS realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentëve. Zyra e IT-së është përgjegjëse për administrimin e të dhënave në sistem. (Ref. RVB, fq.50)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Nga shqyrtimi i RVB, rezulton se për shkak se program është i riorganizuar dhe viti akademik 2018 – 2019 ishte viti i fillimit, ende nuk ka një raport analitik mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit. Rekomandohet që Departamenti në vijim të realizojë raporte analitike periodike, pasi mungesa e një raporti të tillë kufizon vlerësimin sa më real të programit. (Ref. RVB, fq.50)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në Statutin e Institucionit studentët përfshihen në disa struktura si: Senati Akademik (Kryetari i Këshillit Studentor dhe dy student të tjerë përfaqësues të tre cikleve të studimit); Këshilli i studentëve/Këshillat e studentëve në nivel njësie kryesore; 1 student në Këshillin e Etikës; 1 student KSBC.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rreguloren e UET, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve dhe në vlerësimin e procesit akademik përmes Fokus Grupeve dhe Pyetësorët Online. Rezultatet e këtyre instrumentave trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Nga vizita në institucion dhe takimi që kemi patur me përfaqësues të KSBC na u tha se për shkak të konfidencialitetit rezultatet e Fokus Grupeve apo pyetësorëve online nuk mund të na viheshin në dispozicion. GVJ pati mundësi të shikonte vetëm pyetjet që realizohen me Fokus Grupet. Rekomandohet që analiza të vlerësimit të procesit akademik nga ana e studentëve të trajtohen në nivel më të gjerë dhe të bëhen të aksesueshme dhe transparente.(Ref. Takimi me anëtarët e GVB; Takimi me përfaqësues të KSBC-së)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit MP në Studime të Sigurisë është vërejtur një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore në të dy semestrat. Ndyshimet në program (riorganizimi) është bërë konform akteve ligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik u theksua rëndësia dhe vlera e organizimit të mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur për studentët. Nuk disponohet ndonjë dokument/procedurë/proces-verbal që vërteton përfshirjen dhe kontributin e studentëve në procesin e hartimit apo rishikimin e programeve të studimit ku të jenë marrë për bazë sugjerimet e tyre në rastin konkret për riorganizimin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në Rreguloren e Universitetit, neni 32 “Kërkesa për Rivlersim” përcaktohet procedura në rast ankese nga studenti. Studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t’i drejtojë Përgjegjës të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimit. Vlerësimi që bën komisioni i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe</p>



	mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka një zyrë të posaçme “Zyra e Kujdesit ndaj Studentit” e cila realizon informimin, mbështetjen dhe ndjekjen e studentit gjatë vijimit të studimeve. Në rregulloren: “Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit” përcaktohet se ZKS: “shërben si burim primar i informacionit dhe këshillimit rreth mundësive të studimit. Anëtarët e stafit ndihmojnë studentët të përfshihen në jetën e kampusit, mësojnë studentët në lidhje me politikatat e Universitetit, ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore, menaxhojnë hapësirën ku qëndrojnë studentët e qeverisë”. Gjithashtu këshilluesit e karrierës në çdo departament janë në shërbim të studentëve.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në nivel universiteti funksionon “Zyra e Këshillimit të Karrierës”. Kjo zyrë e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit. Studentët e interesuar kanë mundësi të marrin shërbim sipas orareve të shpallura të pritjes, gjithashtu kontaktet e personave që këshillojnë janë publikë. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht përmes e-mailit. (Ref. dok: “Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit”)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Karrierës në detyrat e saj ka gjithashtu dhe gjurmimin e studentëve pas diplomimit dhe përpunon statistika mbi Alumnin. Përsa i takon të dhënave për këtë master nuk kishte informacion të përpunuar. (Ref. dok: “Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujderit ndaj studentit” E.VII.6 pika g)			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UET janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC).			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mesimore e kërkimore. Institucioni angazhon dhe ekspertë të jashtëm pranë KSBC-së. Institucioni ka një Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017–2022 për realizimin e objektivave të cilësisë. Gjithashtu zyra e Standardeve dhe Cilësisë realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në UET. (Ref. RVB, fq. 54; Takimi me përfaqësues të KSBC,)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit. (Ref. RVB, fq.54)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Bazuar në RVB fq.54 dhe Manualin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, përmes planit të veprimit të përvitshëm struktura përgjegjëse KSBC programon punën. Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


<b>Standardi VI.2</b>
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



**periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është KSBC-ja. Në nivel njësie bazë është Departamenti i cili ka programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e gruplëndëve. Nga takimi me anëtarë të KSBC-së na u bë me dije se “Komisioni funksionon që prej vitit 2009, përveç kryetarit ka përfaqësues nga të gjithë fakultetet e UET, ka përfaqësues nga personeli administrativ dhe nga studentët. Komisioni operon me një plan vjetor që miratohet në fillim të vitit nga Rektori. Komisioni fokusohet tek shqyrtimi i silabuseve, tezave të provimit etj. (Ref. Takimi me anëtarë të KSBC; RVB)			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni përmes KSBC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti.(Ref.RVB, fq.55)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Institucioni dhe struktura përgjegjëse KSBC përmes planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Theksojmë se Raportet nuk ishin të mundura për shqyrtim nga ana e GVJ për shkak të konfidencialitetit. Sikundër pranohet në RVB Standardi VI.5 Kriteri 2 fq.59 “raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë”. Në dokumentat e vendosura në dispozicion nga institucioni janë të formatit e-mail me përmbajtje Relacion mbi monitorimin e silabuseve (dok. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset (Ref. Nr. 30.7)			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raportet e realizuara nga KSBC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në disa nivele. Bazuar në RVB-në monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga KSBC-ja. (Ref. Takimi me anëtarë të KSBC; RVB, fq.55; dok: Metodologjia e punës së KSBC-së, provimet)			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi VI.3**

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
-----------------	-------------------------------	--	--	--

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>KSBC-ja realizon vlerësim në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. Nuk harton relacione specifike në bazë programi. Departamentet realizojnë një analizë të përgjithsme për programet e studimit që ato ofrojnë. Këto raporte vetvlerësimi nga ana e departamenteve shqyrtohen nga KSBC-ja për realizimin e vlerësimit të përgjithshëm. (Ref. Takimi me anëtarë të KSBC; RVB)</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me anëtarë të KSBC (dhe shqyrtimi i RVB) na u bë me dije se përdoren disa instrumeta për realizimin e procesit të vlerësimit si: Në çdo semestër me anë të sistemim LMS realizohet vlerësimi për çdo lëndë të çdo pedagogu nga studentët; Përdorimi i fokus grupeve; Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit; Follow up me stafin etj.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit. Për kategorinë lektor/asistent lektor realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Gjithashtu vlerësimi që japin studentët për procesin mësimor nga sistemi LMS është një tjetër instrument. Format i vlerësimit të performancës akademike të studentëve bëhet nga një ndërthurje instrumentash si testim me shkrim, detyra kursi, aktivizimi etj. (Ref. RVB; Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori/kolegu; Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes sistemit LMS; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të</p>	<p>Ka disa aktorë që përfshihen në proces si: Bordet e tregut të punës;</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si TEMPUS “ENCHASE” dhe Erasmus+ QAINAL. (Ref. RVB, fq.57-58)			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Stafi i KSBC-së përbëhet nga 11 anëtarë. Përgjegjësitë dhe detyrat e njëjësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor mbi të cilin funksionon UET. (Ref. Takimi me NJSBC, RVB, fq.58)			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Sikundër është trajtuar dhe më lart, raporti është në nivel institucional. Institucioni nuk realizon raporte në nivel program studimi. (RVB – fq. 56)			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Ka disa standarte të cilat respektohen për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit. Bazuar në RVB fq.58 anëtarët nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, kompetenca profesionale, paanshmëria etj.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Institucioni angazhon ekspertë të jashtëm në strukturën e KSBC, gjithashtu realizon takime me Bordin e Tregut të Punës. Struktura e BTP përbëhet nga studentë të diplomuar dhe të punësuar dhe ka 11 anëtarë. (Ref. RVB; Takimi me Zyren e Keshillimit të Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studenteve)			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë operon në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i Institucionit. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017–2022 janë gjithashtu dokumenta të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Këto dokumenta janë të aksesueshme. (Ref. Plani i veprimit KSBC 2018 – 2019)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Vlerësimi është në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese dhe në departament trajtohet me stafet akademike elementë që lidhen me veprimtarinë e tyre. Duke qenë se

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

legjislaconin për të dhënat personale.	raportete e KSBC-së nuk janë të aksesueshme, sygjerohet një përmbledhje e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të jenë publike dhe të aksesueshme për studentët dhe më gjerë.(Ref. RVB, fq.59)			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon një proces vijueshmërie të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Departamenti reflekton nga rezultatet e Raportit dhe trajton masat që lidhen me programet e studimit që ai mbulon. (Ref. RVB, fq.59)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e KSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesit në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. (Ref. RVB, fq.59)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Studime të Sigurisë, me profile: 1. Çështje të Sigurisë; 2. Studime Rajonale; 3. Gjeopolitikë; 4. Siguria e Sistemeve të Informacionit; 5. Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit është i vetmi program në Shqipëri që është dedikuar për fushën e politikave të sigurisë.
2. Programi i studimit fokusohet me çështje specifike dhe bashkëkohore në fushën e studimeve të sigurisë. Institucioni është shumë i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit.
3. Programi i studimit është në harmoni me interesat kombëtare pasi një program i tillë ka një rol të rëndësishëm në arritjet e interesave kombëtare siç janë përgatitja e vendit për integrim në BE, në kontributin e saj në NATO, dhe për pajisjen e vendit me njerëz të përgatitur në fushën e sigurisë.
4. Programi mbulohet nga staf i kualifikuar akademik me tituj dhe grada që garanton cilësi në mësimdhënie.
5. Infrastruktura e Universitetit mundëson metoda bashkëkohore përmes teknologjive të reja dhe sistemeve që lehtësojnë aksesin pedagog-student.

**Pika të dobta**

1. Vërehet që në shumë dokumente të institucionit nuk është paraqitur data kur dokumentët janë pranuar dhe miratuar nga institucioni. Ekziston gjithashtu akses i kufizuar i publikut në dokumentet e universitetit dhe programit të studimit.
2. Vërehet mungesa e projekteve hulumtuese me fokus të veçantë në studimet e sigurisë që mund të bashkëveprojë me programin e studimit.
3. Institucioni mbështetet kryesisht në tarifat e shkollimit të studentëve, dhe është vulnerabël ndaj trendit në ulje të numrit të studentëve për këtë program studimi.
4. Mungon organizimi i institucionalizuar i praktikave profesionale për studentët.
5. Vërehet mungesa e publikimit për publikun më të gjerë të rezultateve dhe analizave semestrale ose vjetore të vlerësimeve online të studentëve për cilësinë e mësimdhënies.

## Rekomandime

1. Dokumentet e institucionit dhe programit të studimit duhet të kenë datat kur ato janë miratuar. Dokumentet e institucionit dhe të programit të studimit, siç janë rregullorja e programit të studimit; syllabuset e programit të studimit, etj., duhet të jenë aksesueshme edhe për publikun më gjerë në faqen zyrtare të universitetit në internet.
2. Rekomandohet të azhurnohet Rregullorja e programit të studimit duke u referuar objektivave që kanë të bëjnë direkte me dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.
3. Rekomandohet që çdo student ose stafi duhet të ketë akses direkt në përdorimin e bibliotekës me kartën studentore ose stafit, pa kushtëzuar me regjistrimin në Bibliotekë.
4. Sugjerohet fillimi i një projekti hulumtues me financimin nga institucioni në fushën e studimeve të sigurisë që mund të kontribuojë në përfshirjen e pedagogëve të programit të studimit në shkencën ndërkombëtare në fushën e studimeve të sigurisë. Gjithashtu, me vlerë do të ishte që institucioni të mbështesë anëtarët e stafit akademik në realizimin e kërkimit shkencor me anë të një sistemi të mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, egziston nevoja për aktivizimin e studentëve në aktivitetet kërkimore dhe mësimore.
5. Institucioni duhet të vazhdojë të punojë në aplikimet e projekteve si një mjet për të zvogëluar varësinë financiare nga tarifat e shkollimit të studentëve.
6. Ekziston nevoja për hartimin e një plani strategjik kushtuar departamentit dhe programit të studimit.
7. Institucioni duhet të hartojë një dokument të integruar, për shembull një Guidë Studenti dhe Stafi në formë të shkruar dhe elektronike, të azhurnuar çdo vit, që përmban informacionin dhe rregullat e nevojshme për programet e studimit.
8. Institucioni duhet të forcojë institucionalizimin e organizimit të praktikës profesionale për studentët.
9. Rregullorja e programit të studimit duhet të marrë në konsideratë përfshirjen e aspekteve që kanë të bëjnë me nevojën e kërkimit të lëndëve adaptuese për studentët që vijnë nga fusha të cilat nuk janë ndërlidhur me shkenca politike ose marrëdhëniet ndërkombëtare.

10. Rekomandohet që rezultatet dhe analizat e vlerësimeve online të studentëve për cilësinë e mësimdhënies të jenë të aksesueshme për studentët dhe më gjërë.
11. Rekomandohet që në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të dytë, master profesional “Studime të Sigurisë” të përfshihet një procedurë për mënyrën sesi do të konceptohet provimi përfundimtar me “rast studimor kompleks”.
12. Përfshirja dhe kontributi i studentëve në procesin e hartimit apo rishikimit të programeve të studimit të jetë i dokumentuar.

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master in “Security Studies, with Profiles: 1. Security Issues; 2. Regional Studies; 3. Geopolitics; 4. Security of Information Systems; 5. Project Management and Evaluation” at the European University of Tirana**

**Strengths and affirmations**

1. The study program is the only program in Albania dedicated to the field of security policy.
2. The study program focuses on specific and contemporary issues in the field of security studies. The institution is very committed to the internationalization of study programs.
3. The study program is in line with national interests as such a program has an important role to play in achieving national interests such as preparing the country for EU integration, its contribution to NATO, and equipping the country with people prepared in the field of security.
4. The program is covered by qualified academic staff with degrees and qualifications that guarantee quality in teaching.
5. University infrastructure enables contemporary teaching methods through new technologies and systems that facilitate student-teacher access.


**Weak points**

1. It is noted that many documents of the institution do not indicate the date when the documents were accepted and approved by the institution. There is also limited public access to university documents and study programs.
2. There is a lack of research projects with particular focus on security studies that may interact with the study program.


3. The institution relies heavily on student tuition fees, and is vulnerable to the decreasing trend in the number of students for this study program.
4. There is lack of institutionalized organization of professional internships for students.
5. There is a lack of publication to the general public of semester or yearly results on online student assessment of teaching quality .

### **Recommendations**

1. The documents of the institution and study program should have the dates when they were approved. Institution and study program documents, such as study program regulation; study syllabuses, etc., should also be accessible to the general public on the university's official website.
2. It is recommended to update the Regulation of the study program with reference to the objectives that relate directly to the knowledge, skills and professional competences that students should acquire at the end of the study program.
3. It is recommended that every student or staff member should have direct access to the library using the student card or staff card, without being subject to library registration.
4. It is suggested to start a research project funded by the institution in the field of security studies that may contribute to the involvement of lecturers of the study program in international science in the field of security studies. Also, it would be worthwhile for the institution to support members of the academic staff in conducting scientific research through a system of financial support for participation in conferences and scientific activities, organized at home and abroad. Also, there is a need for student activation in research and teaching activities.
5. The institution should continue to work on project applications as a means to reduce the financial dependency on student tuition fees.
6. There is a need for designing a strategic plan dedicated to the department and to the study program.
7. The institution should develop an integrated document, for example a Student and Staff Guide in written and electronic form updated annually, containing the information and rules necessary for study programs.
8. The Institution should strengthen the institutionalization of the organization of professional internships for students.



9. The regulation of the study program should consider including aspects related to the need to require adaptive courses for students coming from fields not related to political science or international relations.
10. It is recommended that the results and analysis of online student evaluations of teaching quality should be accessible to students and beyond.
11. It is recommended that the document “Study program regulation of the second cycle professional master of “Security Studies” should include a procedure on how to conceptualize the final exam with “complex case study”.
12. The involvement and contribution of students in the process of composition or revising study programs should be documented.



## Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				<b>X</b>
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			<b>X</b>	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			<b>X</b>	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			<b>X</b>	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			<b>X</b>	

